



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional

“Financë”

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar
Qiriazi”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Dritan Fino
2. Dr. Visar Malaj

Shtator/2019

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM


Kolegji Universitar Qiriazhi ka nisur aktivitetin akademik në vitin 2006. Programi Master Profesional në "Financë", është hapur me Urdhrin nr 46, dt.09/02/2012. Gjatë viteve 2014-2016 veprimtaria e institucionit ka qenë e pezulluar dhe në datën 22.07.2016, me Urdhër nr.937 të MASR, Kolegjit ju hoq pezullimi. Në vijim të ndryshimeve ligjore, në vitin akademik 2016-2017 Insitucioni riorganizohet me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 92, datë 01.03.2017 nga Shkollë e Lartë Universitare Private "Sevasti & Parashqevi Qiriazhi" në Kolegjin Universitar "Qiriazhi".

Fakulteti i Ekonomisë, pas riorganizimit, ofron programet në ciklin e parë të studimeve: "Bachelor" në "Menaxhim Biznesi", dhe "Drejtues Finance", si dhe në ciklin e dytë të studimeve: "Master Profesional" në "Administrim Biznesi" dhe "Financë", si dhe "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi" dhe "Financë".

Raporti i vlerësimit nga ekspertët e jashtëm, shqyrton ecurinë e programit të studimit Master Profesional në "Financë", i cili i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë. Procesi i vlerësimit të jashtëm është fokusuar në:

- programin e studimit,
- misionin e programit,
- kurrikulën,
- stafin akademik (të brendshëm dhe me kontratë),
- procesin e formimit profesional të studentëve,
- kërkimin shkencor,
- funksionimin e infrastrukturave,
- bashkëpunimin me partnerët kombëtare dhe ndërkombëtarë.

Raporti përshkruan analizën e situatës, treguesit e matshëm, si dhe shkallën e përmbushjes së standardeve sipas rubrikave të udhëzuesit të ASCAL-it. Për secilin standard, ekspertët japin vlerësimet respektive. Gjatë vlerësimit u realizuan edhe vizitat në terren me qëllim vlerësimin e shkallës së përmbushjes së kritereve përbërës të gjashtë standardeve kryesore të cilësisë së programit të studimit. Raporti i vlerësimit është hartuar nga grupi i ekspertëve të jashtëm të vlerësimit i cili përbëhet nga: Dr. Visar Malaj dhe Dr. Dritan Fino. Paraprakisht, anëtarët e grupit morën pjesë në një seancë trajnimi të zhvilluar nga ekspertët e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Grupi i ekspertëve përdori dokumentacionin që ka vënë në dispozicion Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të lartë (ASCAL), në faqen e saj zyrtare, në dokumentacionin shtesë, të kërkuar në institucion, të administruar zyrtarisht si dhe në opinionet e shprehura nga takimet gjatë vizitës në institucion, në datat 28/06/19 dhe 29/06/19. Gjatë vizitave u kryen takime dhe intervista të shumta me hartuesit e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB), me personelin drejtues, akademik, administrativ dhe me studentët që ndjekin programin Master Profesional në Financë. Gjatë vizitave u krye edhe shqyrtimi fizik i të gjitha ambienteve të institucionit dhe atij bazë përgjegjës për programin e studimit.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) përbëhet nga 6 Rubrika kryesore. Çdo rubrikë është analizuar dhe vlerësuar, nëpërmjet standardeve përkatës. Analiza përmban vlerësimin për çdo kriter të secilit standard, duke vlerësuar të dhënat e deklaruara në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) të përgatitur nga institucioni. Ekspertët kanë evidentuar ndryshimet dhe kanë vlerësuar nëse ka ndryshime dhe sa këto ndryshime ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me kriteret specifike. Për secilin standard, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është përgjigjur konkretisht për çdo kriter dhe për çdo standard, nëse plotësohet apo jo dhe për shkallën e vlerësimit. Raporti përmbillet me një analizë përmbledhëse të anëve të forta dhe të dobëta lidhur me programin e studimit Master Profesional në "Financë".

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u prit mjaft mirë nga personeli i institucionit dhe i falenderon përzemërsisht të gjithë për bashkëpunimin e plotë dhe transparent gjatë gjithë këtij procesi.

Menaxhere teknike e ndjekjes së këtij programi studimi është Specialistia e ASCAL, Znj Suela Kromidha

Shënim i GVJ: Vlerësimi sipas standardeve për këtë program studimi, ka ngjashmëri me vlerësimin sipas standardeve të GVJ për programin Msc në Financë për arsye se:

- Njëri anëtar i GVJ ka ndjekur programin Msc në Financë dhe programin Mp në Financë
- Anëtarët, pjesë përbërëse e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm në këtë program studimi, kanë qënë po të njëjtët anëtarë që kanë hartuar edhe Raportin e Vlerësimit të Brendshëm për Msc në Financë dhe shumica e përgjigjeve dhe kriterëve në RVB janë pothuajse njësoj.
- Staf akademik, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Kërkimit Shkencor, janë të njëjta në aktivitetin akademik për të dy programet e studimit, Mp dhe Msc në Financë.

Më datë 17.09.2019 nëpërmjet sistemit AMS por edhe me shkresë zyrtare Nr 143/38, datë 17.09.2019 "Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të vlerësimit të jashtëm", është dërguar në Kolegjin Universitar "Qiriazi" Draft RVJ e programit Mp në "Financë". Më datë 20.09.2019 me shkresë Nr 207/1, datë 20.09.2019 "Mbi Draft Raportin e vlerësimit të jashtëm, për programin e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në "Financë", vjen në ASCAL përgjigja e KUQ mbi këtë Draft.

GVJ Ju përcoll ky dokument dhe për këto komente, Ekspertët e GVJ japin përgjigje si më poshtë:

Komenti i GVB: Fusha VI, standardi VI.3. nw asnjërin prej kriterëve nuk ka vërejtje apo sugjerime nga ana e GVJ, e megjithatë është vlerësuar me "Përmbushen kryesisht". Mendojmë se ky vlerësim duhet riparë.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Po këtu, tek standardi VI.5, kriteri 5, bëhet një vërejtje dhe i gjithë standardi vlerësohet "Përmbushen kryesisht". Mendojmë se edhe ky vlerësim duhet riparë. Nëse rivlerësohen këto dy standarde atëherë mendojmë se duhet riparë vlerësimi i gjithë fushës VI-të.

Përgjigja e GVJ: Në lidhje me Standardet VI.3 dhe VI.5, duhet të qëndrojnë vlerësimet që kemi dhënë në raportin paraprak. Në vlerësimet e kriterëve përkatëse të këtyre standardeve, kemi bërë shpjegimet në të cilat nuk paraqiten qëndrime pozitive apo negative për kriterin, por vlerësim në lidhje me çfarë është konstatuar gjatë procesit të vlerësimit nga ana e grupit të vlerësimit. Sugjerimet apo rekomandimet në tërësi jepen tek Analiza SWOT. Për këtë arsye, GVJ nuk bën ndryshime në RVJ përfundimtar.

Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i jashtëm dhe firmoset nga Ekspertët e vlerësimit.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional 'Financë'

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë 'Master profesional' në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programet e studimit të Kolegjit Universitar 'Qiriazi' (KUQ) nuk bien ndesh me interesat kombëtare, kjo për shkak të natyrës specifike shkencore të degëve të ndryshme të ofruara. Kjo vlen gjithashtu për Masterin Profesional 'Financë', i cili synon të përgatisë profesionistë në fushën e financës dhe kontabilitetit në sektorin privat dhe në atë publik. (Anex III 2 1 Dosja e programit studimit MP_Finance, seksioni 4.3., pika b)</p> <p>Gjithashtu, historiku i KUQ lidhet ngushtë me përkrahjen e interesave kombëtare: zanafilla e tij ishte në 1922 kur motrat Qiriazi dhe Kristo Dako, personazhe të angazhuar në zgjidhjen e çështjeve kombëtare shqiptare, themeluan Institutin Femëror Kyrias. (faqja zyrtare e KUQ: https://www.qiriazi.edu.al/rreth-nesh/historiku-kuq/)</p> <p>Programet e studimit të KUQ mbështeten në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. KUQ ka për mision dhe qëllim, midis të tjerash, të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit (Anex I 1 Statuti i KUQ, neni 3, pika c)</p>
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Baza e mësimdhënies të KUQ janë traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit. (Anex I 1 Statuti i KUQ, neni 3)</p> <p>Programet hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës, me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bien ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të Lartë. (Anex I 3 Rregullore e KUQ, kreu IV, neni 21/b)</p> <p>Misioni i KUQ, midis të tjerash, lidhet me rritjen e standardit të demokracisë, të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e brezit të ri për një shoqëri të tillë. (Anex I 2 Plani Strategjik i Zhvillimit të Kolegjit Universitar 'Qiriazi', seksioni II)</p>

	<p>Një prej qëllimeve të studimeve të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në 'Financë' është ruajtja dhe konsolidimi i vlerave akademike e kulturore kombëtare të vendit tonë. (Anex III_2_1_Dosja e programit studimit MP_Finance, seksioni 4.3., pika b)</p>			
<p>Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Misioni dhe qëllimet e KUQ lidhen, midis të tjerash, me zhvillimin e dijeve përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ofrimin e mundësive të përfitimit nga arsimi i lartë, mbështetjen e interesave të vendit, përgatitjen e specialistëve të lartë, kryerjen e kërkimeve shkencore në bashkëpunim me institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit. (Anex I_1_Statuti i KUQ, neni 3)</p>			
	<p>Misioni i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në 'Financë' është përgatitja e specialistëve të 'Financës', me aftësitë për të menaxhuar veprimtari ekonomike të vogla e të mesme publike e private. Programi është hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për zhvillim (2016-2021) të KUQ. (Anex III_2_1_Dosja e programit studimit MP_Finance, seksioni 4.1.)</p>			
<p>Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Në rregulloren e KUQ theksohet, midis të tjerash, se: 'Programet e KUQ hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës, me zhvillimin ekonomik të vendit'. (Anex I_3_Rregullore e KUQ, kreu IV, neni 21/b)</p> <p>Një prej objektivave të studimeve në fakultetin e Ekonomisë të KUQ lidhet me zhvillimin e programeve të reja të studimit në përshtatje me nevojat e shoqërisë, kushtet ekzistuese dhe perspektivat e zhvillimit të vendit tonë. (Anex II_1_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, kreu IV, neni 17/3)</p> <p>Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në 'Financë' fokusohet në çështjet e financave të korporatave me theks në zhvillimin dhe aplikimin e aftësive të modelimit financiar. Studentët përgatiten për pozicione të tilla në përputhje me nevojat e tregut në Shqipëri. (Anex III_2_1_Dosja e programit studimit MP_Finance, seksioni 4.5.)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në 'Financë' është hartuar në përshtatje me planin strategjik të zhvillimit të institucionit, i cili ka si objektiva kryesorë, midis të tjerash, sigurimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, një detyrë kryesore e personelit akademik dhe strukturave të KUQ.

(Anex_I_2_Plani Strategjik i Zhvillimit të Kolegjit Universitar 'Qiriaz', seksioni IV, pika b)

Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në 'Financë' është hartuar në përshtatje me statutin dhe rregulloren e KUQ.

(Anex_I_1_Statuti KUQ; Anex_I_3_Rregullorja KUQ)

Lëndët dhe modulet e programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në 'Financë' zhvillohen me anë të metodave bashkëkohore, duke u dhënë mundësi studentëve që të pozicionohen qartësisht në karrierën e ardhshme profesionale.

(Anex_III_1_1_Rregullore e Programit të Studimit MP 'Financë', neni 4)

Misioni i programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në 'Financë' është, midis të tjerash, përgatitja e specialistëve të 'Financës', si dhe pajisja e studentëve me një sistem bazë njohurish në fushën e financave të biznesit. Programi mundëson studimin teorik dhe aplikativ në fushën e Ekonomisë në përputhje me Strategjinë Kombëtare për zhvillim të KUQ (2016-2021). Ky program studimi është në përputhje me qëllimet dhe misionin e Kolegjit Universitar 'Qiriaz', si dhe me fushën e veprimtarisë së tij në Ekonomi.

(Anex_III_2_1_Dosja e programit studimit MP_Finance, seksioni 4.1.; Anex_I_2_Plani Strategjik i Zhvillimit të Kolegjit Universitar 'Qiriaz'; Anex_I_1_Statuti KUQ; Anex_I_3_Rregullorja KUQ).

Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.

KUQ zhvillon mësimdhënie cilësore në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në dy Fakultete: Fakulteti i Ekonomisë si dhe Fakulteti i Drejtësisë. Ata ofrojnë programe studimi Bachelor: Menaxhim Biznesi, Drejtues Finance, Biznes e Ligj; Master Profesional: Administrim Biznesi, Financë; Master Shkencor: Administrim Biznesi, Financë, E drejtë civile dhe tregtare.

(Anex_I_15_1_raporti vjetor 2017-2018, Fq.3)

Studimet në Fakultetin e Ekonomisë të KUQ synojnë arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e ekonomisë: më konkretisht në fushën e menaxhimit të ndërmarrjeve, financës dhe kontabilitetit.

	<p>(Anex_II_1_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, kreu IV, neni 16).</p> <p>Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në 'Financë' ofrohet në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të institucionit.</p> <p>(Anex_III_1_1_Rregullore e programit të studimit 'Financë')</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë 'Master profesional' hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Arritjet më të mira ndërkombëtare në përgjithësi dhe ato evropiane në veçanti, janë baza e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në KUQ.</p> <p>(Anex_I_1_Statuti KUQ, neni 3)</p> <p>KUQ ka për mision dhe qëllim, midis të tjerash, të kontribuojë në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.</p> <p>(Anex_I_1_Statuti i KUQ, neni 3, pika c)</p> <p>Misioni i KUQ lidhet, midis të tjerash, me përgatitjen e individëve të aftë për t'u përshtatur me zhvillimet shoqërore dhe ekonomike të vendit tonë, si dhe me zhvillimet më të fundit ndërkombëtare.</p> <p>(Anex_I_2_Plani Strategjik i Zhvillimit të Kolegjit Universitar 'Qiriazi', seksioni II)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.3

Programet e studimit 'Master profesional' synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit 'Master profesional' kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Objektivat, misioni, struktura, mënyra e funksionimit të studimeve, si dhe të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik, studentëve, rregullat e pranimit të studentëve, mësimdhënies, praktikave, diplomimit dhe sanksionet në rast të shkeljes së rregullore për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në 'Financë' janë të përcaktuara në rregulloren përkatëse.</p> <p>(Anex_III_1_1_Rregullore e Programit të Studimit MP 'Financë')</p> <p>Në çdo program lënde përfshihet përshkrimi përkatës, objektivat, temat, konceptet themelore, përmbajtja, literatura, detyrimet e studentit dhe sistemi i vlerësimit të tij.</p> <p>(Anex_III_2_4_Syllabuse_MP_Finance)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për</p>	

programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.

Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.

Përpara hapjes së programeve të studimit të profileve të ndryshme, KUQ kreu një analizë të tregut të punës. Studimi synon të kryejë një analizë të përditësuar të kërkesë/ofertës, duke krahasuar ndryshimet e tregut të punës për profesione të ndryshme me ofertën prezente në këtë treg për personel të specializuar në fusha të caktuara. Sipas autorëve, studimi evidenton tendencën e ndryshimeve të tregut të punës dhe arritjen e ekuilibrave të qëndrueshëm ndërmjet kërkesës dhe ofertës për profesione të caktuara. Autorët e studimit konstatojnë se rasti më tipik i këtij ekuilibri është kërkesa konstante për specialistë të fushave të financë-kontabilitetit, gjë që shprehet nëpërmjet treguesit konstant të periudhës së kohës që ju duhet këtyre specialistëve nga mbarimi i shkollës deri në gjetjen e punës së parë. Gjithashtu, në këtë studim theksohet se analiza e tregut të punës para hapjes së një programi studimi në KUQ ka qenë e vazhdueshme.
(Anex I_12_Mbi studimin e tregut e punës tetor 2017)

GVJ konstaton se: Pavarësisht konkluzioneve të rëndësishme të këtij studimi, autorët nuk japin sqarime të detajuara mbi metodologjinë statistikore të përdorur, si dhe mbi statistikat përshtuesive të lidhura me kampionët e përdorur. Studimi i publikuar është relativisht i limituar, si në volum, ashtu edhe si produkt shkencor. Gjithashtu, një prej konstatimeve kryesore të autorëve të studimit (kërkesa konstante për specialistë të fushave të financë-kontabilitetit) nuk është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me programin (ose objektivat) e Masterit Profesional në 'Financë'. Në bazë të opinionit tonë si ekspertë të ekonomisë dhe financës, gjykojmë se tregut shqiptar të punës i nevojiten të diplomuar nga programe me fokus më të ngushtë ose më specifik. Emërtimi dhe objektivat e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në 'Financë' përfshijnë, në gjykimin tonë, një fushë 'të gjerë', edhe për vetë kohëzgjatjen, relativisht të limituar të studimeve.

Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.

KUQ ofron mundësi për njohjen e krediteve sipas kërkesave për vazhdimin ose transferimin e studimeve, midis të njëjtit cikël, brenda të njëjtit institucion ose në institucione të tjerë brenda dhe jashtë vendit.

(Anex I_1_Statuti i KUQ Neni 34)

Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.

Sipas RVB dhe anekseve përkatës, programi Master Profesional në 'Financë' është ndërtuar mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga Ligji për Arsimin e Lartë, Standardet Shtetërore të Cilësisë, Karta e Bolonjës, ZEAL (Zona Europiane e Arsmi të Lartë), nga Udhëzimet e MASR dhe të ASCAL; ky program mbështetet gjithashtu në aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe zbaton kërkesat e akteve rregullatore të institucionit. Programi i Studimit Master Profesional në 'Financë' është hartuar në përputhje me objektivat e

	<p>përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë.</p> <p>Programi i Studimit Master Profesional në 'Financë' është i vlerësuar në kredite, sipas ECTS (Sistemi European të Trasferimit dhe Grumbullimit të Krediteve) dhe Kartës së Bolonjës. Siç edhe e kemi theksuar edhe më lart, gjykojmë se tregut shqiptar të punës i nevojiten të diplomuar nga programe me fokus më të ngushtë ose më specifik. Emërtimi dhe objektivat e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në 'Financë' përfshijnë, në gjykimin tonë, një fushë 'të gjerë', edhe për vetë kohëzgjatjen, relativisht të limituar të studimeve.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë 'Master profesional' përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Sipas RVB dhe anekseve përkatës, programi i ciklit të dytë Master Profesional në 'Financë' përfshin aftësimin profesional në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. Praktika profesionale është pjesë e programit të studimeve (për të dy ciklet) për fushat e diplomimit në KUQ. Kryerja e saj është e detyrueshme për studentët e sistemit me kohë të plotë. Në planin mësimor 2018-2019, praktika profesionale kryhet në dy javë dhe përmban 4 ECTS. Praktika profesionale synon thellimin e njohurive teorike dhe profesionale të studentëve. Praktika profesionale mund të kryhet edhe jashtë shtetit, me kusht sigurimin e qëllimeve të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit Master Profesional 'Financë'.</p> <p>(Anex III 1 1 Rregullore e Programit të Studimit MP 'Financë', Neni 42; Anex II 6 Rregullore e Departamentit të Financës, Kreu II, neni 16)</p>
<p>Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë 'Master profesional' mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Sipas RVB dhe anekseve përkatës, në KUQ nuk ka mësimdhënie, as lëndë në gjuhë të huaj në asnjë program studimi. Në të ardhmen, organet drejtuese të KUQ po studiojnë një mundësi të tillë në kuadrin e bashkëpunimit me Institucione homologe Evropiane.</p> <p>(Anex I 13 Lista e bashkëpunimit ndërinstitucionale Kolegjit)</p> <p>Sigurisht, elementët e mësimdhënies në gjuhë të huaj janë thelbësorë për shkallën e ndërkombëtarizimit të universitetit. Kjo mangësi duhet të plotësohet në të ardhmen e afërt.</p>
<p>Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë 'Master profesional' mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Sipas RVB, programi i ciklit të dytë Master profesional në 'Financë' mund të hapet përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar, konkretisht në një drejtim specifik të ekonomisë dhe biznesit.</p> <p>Duhet të ketë një plan të qartë dhe të detajuar mbi drejtimet e mundshme specifike në të ardhmen, në varësi të dinamikave të tregut të punës.</p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
			X	

Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë 'Master profesional' janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga vizita e ekspertëve të vlerësimit në institucion, sipas datave të programuara, në zyrën e burimeve njerëzore, në disa raste të veçanta u evidentuan parregullsi në dosjet personale të personelit akademik efektiv dhe me kontratë të Masterit Profesional në 'Financë'. Më konkretisht, në disa raste u evidentuan mangësi dhe pasaktësi të pjesshme të dokumentave në këto dosje, si për shembull mungesë CV-je, mungesë të pjesshme të diplomave të studimeve universitare. Gjithashtu, gjatë takimit me studentët aktualë të Masterit Profesional në 'Financë' u konstatuan në disa raste të veçanta mospërputhje të emrave të stafit akademik mësimdhënës, në krahasim me listën e pedagogëve të aneksit përkatës.</p> <p>(Anex_III_2_3_StafiAkademik_MPF; Anex_II_8_Lista e dokumentave ne dosjen e personelit; Anex_III_2_2_1_ProgramStudimi_2016-2017)</p> <p>Drejtuesit e KUQ (Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Rektori), Përgjegjësi i zyrës së burimeve njerëzore dhe një pjesë e stafit akademik të Masterit Profesional në 'Financë' u angazhuan maksimalisht për korrigjimin e këtyre problemeve, konkretisht duke azhornuar sa më shpejt listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të Masterit Profesional në 'Financë' në aneksin përkatës, si dhe duke plotësuar dosjet personale me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.</p> <p>Konkretisht, KUQ dërgoi pas vizitës të ekspertëve në institucion një sërë dokumentesh, midis tyre edhe listën e azhornuar të stafit akademik të programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në 'Financë'.</p> <p>Sipas RVB dhe anekseve përkatës, në Fakultetin e Ekonomisë në KUQ janë të angazhuar 28 anëtarë të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, nga të cilët 11 pedagogë janë pjesë e Departamentit të Financës (DF). Në DF, personel akademik efektiv janë të paktën 7 persona, nga të cilët, të paktën 3 janë personel akademik me grada shkencore dhe tituj akademik, me përvojë në mësimdhënie dhe punë kërkimore, të cilët bashkërendojnë aktivitetin dhe mbështesin kualifikimin edhe të pjesës tjetër të stafit të fakultetit. Si pjesë</p>

	<p>e stafit me kontratë, DF ka në përbërjen e tij të paktën 4 anëtarë, të gjithë me grada shkencore dhe tituj akademik. Pjesë e fakultetit është edhe Qendra Kërkimore Shkencore, e cila ka 7 anëtarë, nga të cilët 3 janë personel me grada shkencore dhe tituj akademik.</p> <p>(Anex_II_7_Numri i stafit Akademik_FE_2016-2018; 1_Ngarkesa mesimore ne MP_MSH_FIN.pdf)</p> <p>Sipas RVB dhe anekseve përkatës, personeli akademik efektiv realizon pjesën më të madhe të ngarkesës mesimore në gjashtë programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë që ka fakulteti. Gjithashtu institucioni ka personel administrativ 3 anëtarë që është në shërbim të punës mesimore, kërkimore dhe shkencore të të gjithë programeve.</p> <p>(Anex_II_7_Numri i stafit Akademik_FE_2016-2018; 1_Ngarkesa mesimore ne MP_MSH_FIN.pdf)</p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Departamenti i Financës i KUQ ofron programe studimi në fushën e financës, si profesionale, ashtu edhe shkencore. Programet e reja janë në sinkron me nevojat e shoqërisë dhe kushtet ekzistuese të vendit. Programet e studimit organizohen në dy nivele: Ciklin e Parë dhe të Dytë. Departamenti i Financës i KUQ synon të sigurojë njohuri të krahasueshme me institutet analoge universitare jashtë vendit.</p> <p>(Anex_II_6_Rregullore e Departamentit të Financës; Anex_II_1_Rregullore FE)</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Sipas RVB dhe anekseve përkatës, programi i Masterit Profesional në 'Financë' mban numrin 7 të kornizës evropiane (dhe shqiptare) të kualifikimit.</p> <p>Duke u bazuar në CV-të e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të Masterit Profesional në 'Financë', përgjithësisht mund të konfirmohet përputhja e karrierës akademike me mësimdhënien në lëndën përkatëse, pjesë e programit të studimit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit të Masterit Profesional në 'Financë' është përgjithësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, si dhe me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë 'Master profesional' në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p>	<p>KUQ nuk ofron programe të ciklit të dytë 'Master profesional' në ndonjë drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit.</p> <p>(Anex_I_1_2_Programet e studimit ne Kolegjin Univ_Qiriazi)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Jo e përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Sipas RVB, institucioni nxit dhe motivon bashkëpunimin e ngushtë të personelit akademik, jo akademik, administrativ dhe studentëve, në përputhje me statutet e tyre, funksionet dhe përgjegjësitë, për arritjen dhe realizimin e qëllimeve institucionale. Bashkëpunimet brenda KUQ janë në mes fakulteteve, si dhe mes departamenteve të fakultetit Ekonomik.</p> <p>GVJ konstaton se: Pavarësisht frymës pozitive të bashkëpunimit në institucion, detyrat duhet të ndahen në mënyrë relativisht të barabartë dhe sipas aftësive të personelit. Gjatë vizitës së GVJ në KUQ, u evidentua, në raste të veçanta, ngarkimi i shumë detyrave te një person i vetëm. Megjithatë, kjo mund të justifikohet disi me numrin e ulët të studentëve dhe madhësinë e institucionit në përgjithësi.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>KUQ ka bashkëpunime ndërinstitucionale me një sërë institucionesh shtetërore dhe IAL brenda e jashtë vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës në përgjithësi.</p> <p>(Anex I_13_Lista e bashkëpunimit ndërinstitucionale Kolegjit)</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë 'Master profesional', institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Studentët mund të lëvizin në kuadër të projekteve të ndryshme, ku KUQ është palë. Atyre u njihen kreditet e mundshme të fituara nëse programet përkatëse janë të barasvlershme.</p> <p>(Anex II_6_Rregullore e Departamentit të Financës, neni 40, 58-64)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Sipas RVB dhe anekseve përkatës, objektivat e këtyre bashkëpunimeve janë realizimi i praktikave profesionale me studentët sipas profilit, shkëmbimi i përvojave reciproke, krijimi i mundësive të punësimit me kohë të pjesshme të studentëve dhe në profil pas përfundimit të studimeve. Praktikave profesionale zhvillohen në institucione, ndërmarrje shtetërore ose private sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe drejtohet nga pedagogu përkatës.</p> <p>(Anex III_1_2_Rregullore e Praktikës Profesionale për FE, Neni 5)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Sipas RVB, KUQ ka qenë gjithmonë në dispozicion për të ofruar trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar për të vazhduar kurse, kryesisht për kontabilitetin, por për shkak të numrit të limituar nuk ka pasur kërkesë. Sipas RVB por e konfirmuar nga GVJ edhe gjatë vizitës në vend, këtë vit është bërë një plan më afatgjatë për organizimin e</p>

	<p>kurseve në bashkëpunim me aktorët e interesuar, ku për studentët do të ketë kushte lehtësuese.</p> <p>GVJ konstaton se kurset dhe trajnimet e planifikuara më sipër duhet të sigurojnë punësim në të ardhmen, sigurisht në bazë të performancës të studentëve të diplomuar. Në rast të kundërt, ata do të ishin pothuajse të panevojshëm, duke patur parasysh specifikat e tregut të punës në vendin tonë.</p>								
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Sipas RVB, Departamenti përkatës dhe rektorati, në funksion të realizimit të programit të studimit, harton raporte analitike ku përfshin edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe të huaja dhe vendase atje ku ka pasur përfitime.</p> <p>GVJ shprehet se në këto raporte duhet të evidentohen qartë përfitimet konkrete për studentët dhe institucionin në përgjithësi.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Jo përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Jo përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Jo përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Sipas RVB dhe sipas anekseve përkatës, programet e studimit të Masterit Profesional në ‘Financë’ janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Planet dhe programet e disiplinave respektive të detajuara, të shoqëruara me kreditet përkatëse, hartohen dhe miratohen në departamente. Për çdo lëndë ose modul, pedagogu përkatës paraqet një program, i cili hartohet sipas formatit të miratuar. Programi miratohet në departament. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese janë organizuar në 5 kategori, nga A në E. Kreditet për çdo lëndë mbajnë parasysh ngarkesën në orë mësimore dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti. Programi i studimit miratohet gjithashtu në Senatit Akademik të KUQ dhe më tej hapja e çdo programi të ri miratohet nga Ministria përgjegjëse. (Anex III 1 1 Rregullore e Program Studimi FE_MP_Fin, neni 13)</p> <p>Kohëzgjatja normale e Programit të studimit të Masterit Profesional në ‘Financë’ është 1 vit akademik (60 kredite) dhe/ose 2 vite akademike (120 kredite). (Anex III 1 1 Rregullore e Program Studimi FE_MP_Fin, neni 11)</p> <p>Viti akademik përbehet nga një ngarkesë prej 1500 orësh në auditor dhe jashtë tij ose 60 kredite ECTS. Viti akademik ndahet në dy semestra, secili me 25 javë mësimore, 15 javë semestri i parë dhe 10 javë semestri i dytë. Programit të studimit të Masterit Profesional në ‘Financë’ përmban lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje, secila me provimin përkatës. Në program përfshihet praktika profesionale dhe provimi i përgjithshëm i formimit ose mbrojtja e diplomës. (Anex III 2 1 Dosja e programit studimit MP_Financë)</p> <p>Në planin mësimor parashikohen të gjitha lëndët të cilat zhvillohen gjatë secilit semestër me kreditet dhe orët e ngarkesave përkatëse. (Anex III 2 2 Programi i studimit MP_FIN_2016-2018)</p> <p>Programet e studimit të ciklit të dytë të Masterit Profesional në ‘Financë’ përfshijnë përgjithësisht lëndë të lidhura me një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. (Anex III 2 2 Programi i studimit MP_FIN_2016-2018)</p>
Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	
Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	
Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	
Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	
Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	
Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafan», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

GVJ konstaton se në program nuk përfshihet një lëndë e Ekonometrisë ose e Ekonometrisë Financiare, shumë e domosdoshme për vetë natyrën e studimeve profesionale në financë. Ky fakt u pranua nga stafi akademik i Masterit Profesional në 'Financë' dhe nga titullarët e KUQ (Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Rektori), të pranishëm në takimin me ekspertet e vlerësimit në institucion. Ata u angazhuan në zgjidhjen e këtij problemi, pra në përfshirjen e kësaj lënde në program në të ardhmen e afërt.

Përpara hapjes së programeve të studimit të profileve të ndryshme, KUQ kreu një analizë të tregut të punës.

(Anex_I_12_Mbi studimin e tregut e punës tetor 2017)

Sipas RVB dhe anekseve përkatës, lëndët apo modulet e Masterit Profesional në 'Financë', janë çdo vit të rifreskuara me literaturën e fundit dhe me të reja në fushën e kërkimit dhe inovacionit. Në syllabusin e secilës lëndë apo modul, tematikat janë bashkëkohore dhe në metodat e mësimnxënies kërkohet nga studentët mendimi kritik për çdo teori dominante të fushës. **Sipas RVB**, gjithashtu zhvillohen seminare në laboratorin e Kontabilitetit. Gjatë këtyre seminareve merren kushtet e një ndërmarrje konkrete dhe kryhen gjithë veprimet kontabël dhe më pas analiza e avancuar e pasqyrave financiare.

Në programin e studimit të Masterit Profesional në 'Financë' janë përfshirë elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit (sipas VKM-së nr. 41, datë 24.1.2018), si kreditet sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, objektivat formues dhe kompetencat profesionale, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit, kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë një program studimi, plani mësimor; kuotat e pranimit dhe grupet mësimore, programi lëndor (Syllabus-et), profilin i programit, diploma dhe suplementin.

(Anex_III_1_1_Rregullore e Program Studimi FE_MP_Fin)

Në aneksin përkatës janë paraqitur gjithashtu kreditet sipas veprimtarive formuese. Kategoritë janë:

A. LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (5%-10%)

B. LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disipinën shkencore (30%-40%)

C. LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (20%-30%)

D. LËNDË PLOTËSUESE –gjuhë të huaja, njohuri informatike, Praktikë Profesionale (10%).

E. DETYRIME PËRMBYLLËSE Provim i Përgjithshëm Përfundimtar/ (10%-20%)

(Anex_III_2_1_Dosja e programit studimit MP_Finance)

	GVJ konstaton se: Në kategorinë D është përfshirë gjithashtu lënda 'Vlerësim i Ndërmarrjeve', e cila qartësisht nuk bën pjesë në këtë kategori. Kjo lëndë mund të zëvendësohet me lëndën 'Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit', e cila është klasifikuar nën kategorinë B. Ky fakt u pranua nga stafi akademik i Masterit Profesional në 'Financë' dhe nga titullarët e KUQ (Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Rektori), të pranishëm në takimin me ekspertet e vlerësimit në institucion. Ata u angazhuan në korigjimin e shpejtë të këtij problemi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Referuar aneksit I.1.2 të programit të studimit të KUQ, organigramës së Fakultetit FE, numrit të stafit akademik FE 2016-2018, konkluzioneve të nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm si dhe kontrollit në institucion nga ekspertët e vlerësimit, sipas datave të programuara, në zyrën e burimeve njerëzore, në disa raste të veçanta, u evidentuan parregullsi në dosjet personale të personelit akademik efektiv dhe me kontratë të Masterit Profesional në 'Financë'. Më konkretisht, në disa raste u evidentuan mangësi dhe pasaktësi të pjesshme të dokumentave në këto dosje, si për shembull mungesë CV-je, mungesë të pjesshme të diplomave të studimeve universitare. Gjithashtu, gjatë takimit me studentët aktualë të Masterit të këtij programi u konstatuan në disa raste të veçanta mospërputhje të emrave të stafit akademik mësimdhënës, në krahasim me listën e pedagogëve të aneksit përkatës. Drejtuesit e KUQ (Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Rektori), përgjegjësi i zyrës së burimeve njerëzore dhe një pjesë e stafit akademik të Masterit Profesional në 'Financë' u angazhuan maksimalisht për zgjidhjen e këtyre problemeve, konkretisht duke azhornuar sa më shpejt numrin e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të Masterit Profesional në 'Financë' në aneksin përkatës, si dhe duke plotësuar dosjet personale me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Referuar të dhënave në RVB, Dokumentacionit të DVV, Aneks II-7, përbërja e Stafit akademik të njësisë kryesore, Fakultetit Ekonomik, ishte si më poshtë: Viti akademik 2017-2018 Departamenti i Financës – 5 PAE (4 me tituj dhe me grada) Viti akademik 2018-2019
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	

	<p>Departamenti i Financës – 5 PAE (4 me tituj dhe me grada)</p> <p>Për arsye të mosplotësimit të kriterit ligjor në të cilën stafi në Departament duhet të ketë 7 të brendshëm, nga të cilët 3 me tituj dhe grada, ASCAL si fillim ka pezulluar kërkesën e KUQ për vlerësimin në kuadër të akreditimit të këtij programi studimi. KUQ me shkresë Nr 113 prot, datë 06.05.2019 “Informacion mbi shkresën Nr 143/1 të ASCAL” ka paraqitur ripërbërjen e Stafit të Departamentit të Financës, sipas të cilës përbërja e Departamentit të Financës për këtë vit akademik, 2018-2019, është si më poshtë: 7 PAE (1 Prof Dr; 2 Dr; 4 Msc) dhe 4 PAK (2 Prof Dr; 1 prof As; 1 Dr)</p> <p>Gjithashtu, u konstatua se në Fakultetin e Ekonomisë në KUQ janë të angazhuar 28 anëtarë të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 11 pedagogë janë pjesë e Departamentit të Financës (DF). - 10 pedagogë janë pjesë e Departamentit të Menaxhim Biznesit (DMB) - 7 pedagogë janë pjesë e Qendrës kërkimore Shkencore të Fakultetit (QKSH) <p>Në DF, personel akademik efektiv dhe 7 persona, nga të cilët, të paktën 3 janë personel akademik me grada shkencore dhe tituj akademik, me përvojë në mësimdhënie dhe punë kërkimore, të cilët bashkërendojnë aktivitetin dhe mbështesin kualifikimin edhe të pjesës tjetër të stafit të fakultetit. Si pjesë e stafit me kontratë, DF ka në përbërjen e tij të paktën 4 anëtarë, të gjithë me grada shkencore dhe tituj akademik. Pjesë e Fakultetit është edhe Qendra Kërkimore Shkencore, e cila ka 7 anëtarë të brendshëm, nga të cilët 3 janë personel me grada shkencore dhe tituj akademik. Ndërkohë, personeli akademik efektiv realizon pjesën më të madhe të ngarkesës mësimore në gjashtë programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë që ka fakulteti. Gjithashtu institucioni ka personel administrativ 3 anëtarë që është në shërbim të punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të të gjithë programeve.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Studentët e KUQ kanë në dispozicion 3 laboratorë, një sallë interneti dhe një bibliotekë. Në çdo rast KUQ angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore dhe laboratorike, pjesë e programit të studimit të Masterit Profesional në ‘Financë’.</p> <p>(Anex 1 11 7 Statistike per mjediset e KUQ; Anex II 9 Lista e personelit akademik Dep Fin)</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Kordinatori i programit të studimit të Masterit Profesional në ‘Financë’ emërohet nga Dekani i Fakultetit, me propozim të Përgjegjës të Departamentit. Koordinatori është në mbështetje të punës të përgjegjës të departamentit dhe menaxhon administrativisht gjithë veprimtarinë e këtij programi në Fakultet. Koordinator, midis të tjerash, duhet të ketë kualifikimin, së paku,</p>

<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>‘Doktor Shkencash’, të mbajë takime të rregullta me pedagogët, të këshillojë studentët për punimin e diplomës. (Anex_III_1_1_Rregullore e Program Studimi FE_MP_Fin, neni 7) Sipas RVB, duke qënë se numri i studentëve është i vogël, koordinatori i programit MP ‘Financë’ është vetë Përgjegjësi i Departamentit.</p> <p>Pavarësisht numrit të vogël të studentëve, sipas opinionit tonë si ekspert, ngarkesa e lartë me detyra të ndryshme mund të ulë efikasitetin dhe performancën në punë të përgjegjësit të Departamentit.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="606 577 762 651">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="762 577 983 651">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="983 577 1203 651">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1203 577 1407 651">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="606 651 762 696"></td> <td data-bbox="762 651 983 696" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="983 651 1203 696"></td> <td data-bbox="1203 651 1407 696"></td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X		
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
	X								

<p>Standardi II.3 Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri I. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Fakulteti Ekonomik i KUQ dhe Departamenti i Financës, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë të Masterit Profesional në ‘Financë’, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Në anekset përkatës gjejmë, midis të tjerash:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregulloret përkatëse (Anex_II_1_Rregullore e Fakultetit Ekonomik; Anex_II_6_Rregullore e Departamentit të Financës; Anex_III_1_1_Rregullore e Programit të studimit MP ‘Financë’) 2. Dosjet e programit të studimit dhe syllabuset (Anex_III_2_1_Dosja e programit studimi FE_MP_Fin; Anex_III_2_2_Programi i studimit MP_FIN_2016-2018; Anex_III_2_4_Syllabuse MP_Financë) 3. Organigrama përkatëse (Anex_II_1_1_Organigrama e Fakultetit Ekonomik) 4. Informacionet për stafin akademik, etj. (Anex_II_9_Lista e personelit akademik_Dep_Fin; Anex_III_2_3_StafiAkademik_MPF; Anex_III_2_3_1_CV_pedagog_MP_FIN; Anex_I_15_1_raportit vjetor 2017-2018)

<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit të Masterit Profesional në ‘Financë’ organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese. Rregullorja e këtij programi përcakton objektivat, misionin, strukturën dhe mënyrën e funksionimit të studimeve, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, stafit akademik, studentëve, mësimdhënien, praktikën, vlerësimin, diplomën, etj.</p> <p>(Anex_III_1_ Rregullore e programit të studimit MP’Financë’)</p> <p>Sipas RVB, modulet e semestrit të parë janë në funksion të objektivave formuese dhe kompetencat profesionale përcaktuese në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Këto kompetenca profesionale përcaktuese presupozohen të jenë të njëjta për programe të ngjashme të fushës së financës.</p> <p>Në kategorinë D është përfshirë gjithashtu lënda ‘Vlerësim i Ndërmarrjeve’, e cila qartësisht nuk bën pjesë në këtë kategori. Kjo lëndë mund të zëvendësohet me lëndën ‘Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit’, e cila është klasifikuar nën kategorinë B.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Siç edhe e kemi theksuar më lart, mbështetur në Rregulloren e programit të studimit MP në “Financë”, në dosjen e plotë të programit MP në “Financë”, në pjesën “Përmbledhje dhe rezultate” dhe “Literatura bazë dhe ndihmëse” e syllabuseve të lëndëve si dhe në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm, u konstatua se programi i studimit Master Profesional në ‘Financë’ është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Planet dhe programet e disiplinave respektive të detajuara, të shoqëruara me kreditet përkatëse, hartohen dhe miratohen në departamente. Për çdo lëndë ose modul, pedagogu përkatës paraqet një program, i cili hartohet sipas formatit të miratuar. Programi miratohet në departament. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese janë organizuar në 5 kategori, nga A në E. Kreditet për çdo lëndë mbajnë parasysh ngarkesën në orë mësimore dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit miratohet gjithashtu në Senatit Akademik të KUQ dhe më tej hapja e çdo programi të ri miratohet nga Ministria përgjegjëse. Kohëzgjatja normale e Programit të studimit të Masterit Profesional në ‘Financë’ është 1 vit akademik me 2 semestra gjithsej (60 kredite). Viti akademik përbëhet nga një ngarkesë prej 1500 orësh në auditor dhe jashtë tij. Viti akademik ndahet në dy semestra, me 25 javë mësimore, 15 javë semestri i parë dhe 10 javë semestri i dytë. Programit të studimit të Masterit Profesional në ‘Financë’ përmban lëndë secila me provimin përkatës. Në kategorinë D (lëndë</p>

	<p>plotësuese) duhen të përfshihen çfarë vetë kjo kategori nënkupton (gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale), duke qënë se këto nuk ishin të përfshira.</p> <p>Programet e studimit të ciklit të dytë të Masterit Profesional në 'Financë' përfshijnë përgjithësisht lëndë të lidhura me një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. Në këndvështrimin e ekspertëve të jashtëm, ky program ka vënd për përmirësim duke ndryshuar lëndët te kategoria D si dhe duke riparë lëndët e kategorisë B. Gjithashtu, referuar dhe dokumentave të sipërpërmendur, lëndët apo modulet e Masterit Profesional në 'Financë', janë çdo vit të rifreskuara me literaturën e fundit dhe me të rejat në fushën e kërkimit dhe inovacionit. Sipas RVB, gjithashtu zhvillohen seminare në laboratorin e Kontabilitetit. Gjatë këtyre seminarëve merren kushtet e një ndërmarrje konkrete dhe kryhen gjithë veprimet kontabël dhe më pas analiza e avancuar e pasqyrave financiare. Në programin e studimit të Masterit Profesional në 'Financë' janë përfshirë elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit (sipas VKM-së nr. 41, datë 24.1.2018), si kreditet sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, objektivat formues dhe kompetencat profesionale, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit, kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë një program studimi, plani mësimor; kuotat e pranimit dhe grupet mësimore, programi lëndor (Syllabus-et), profilin i programit, diploma dhe suplementin. Sipas RVB dhe ashtu sic edhe u deklarua edhe gjate vizitës në këtë Institucion, kjo ndarje është e tillë: Ndjekja e lëndës, frekuentimi dhe aktivizimi 10%, Laboratorët/ detyrat e kursit 10%, Provimi i ndërmjetëm 20% , dhe Provimi përfundimtar 60 %.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Sipas vendimin nr.18, datë 11.01.2017 të Senatit Akademik të KUQ, insitucioni ka përcaktuar kriteret e pranimit të përgjithshme dhe specifike.</p> <p>Sipas këtij dokumenti, studentët që do të pranohen në këtë program studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kanë përfunduar studimet universitare në këtë Kolegj dhe kanë Diplomën "Bachelor" në Drejtësi ose ekonomik - Kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në UT dhe kanë diplomën "Bachelor" - Kanë një diplomë "Bachelor" të fituar në universitetet publike dhe jopublike.
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Mbështetur në rregulloren e programit të studimit MP "Financë", në dosjen e plotë të programit MP "Financë", në pjesën "Përmbledhje dhe rezultate" dhe "Literatura bazë dhe ndihmëse" e syllabuseve të lëndëve si dhe në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm, u konstatua se programi i studimit Master Profesional në 'Financë' është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuar në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit</p>

	<p>Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Planet dhe programet e disiplinave respektive të detajuara, të shoqëruara me kreditet përkatëse, hartohen dhe miratohen në departamente. Për çdo lëndë ose modul, pedagogu përkatës paraqet një program, i cili hartohet sipas formatit të miratuar. Programi miratohet në departament. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese janë organizuar në 5 kategori, nga A në E. Kreditet për çdo lëndë mbajnë parasysh ngarkesën në orë mësimore dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti.</p> <p>Programi i studimit miratohet gjithashtu në Senatin Akademik të KUQ dhe më tej hapja e çdo programi të ri miratohet nga Ministria përgjegjëse.</p> <p>Kohëzgjatja normale e Programit të studimit të Masterit Profesional në 'Financë' është 1 vit akademik me 2 semestra gjithsej (60 kredite).</p> <p>Programet e studimit të ciklit të dytë të Masterit Profesional në 'Financë' përfshijnë përgjithësisht lëndë të lidhura me një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. Në këndvështrimin e ekspertëve të jashtëm ky program ka vënd për përmirësim duke ndryshuar lëndët te kategoria D si dhe duke riparë lëndët e katëgorisë B. Gjithashtu, referuar dhe dokumentave të sipërpërmendur, lëndët apo modulet e Masterit Profesional në 'Financë', janë çdo vit të rifreskuara me literaturën e fundit dhe me të rejtat në fushën e kërkimit dhe inovacionit. Sipas RVB, gjithashtu zhvillohen seminare në laboratorin e Kontabilitetit. Gjatë këtyre seminareve merren kushtet e një ndërmarrje konkrete dhe kryhen gjithë veprimet kontabël dhe më pas analiza e avancuar e pasqyrave financiare.</p>								
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Të dhënat e grumbulluara për programet e studimit ruhen në një dosje të veçantë në arkivën e fakultetit, e cila i vihet në dispozicion grupit të rishikimit të programeve të studimit në momentin e caktuar. Grupi i rishikimit përcakton ndryshimet në çdo element të programit. Raporti i rishikimit të programit të studimit analizohet nga Senati Akademik, i cili e miraton dhe merr masat për zbatimin e planit të veprimeve sipas afateve të përcaktuara.</p> <p>(Anex I 3 Rregullore e KUQ, neni 92)</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="619 1480 778 1547">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="778 1480 983 1547">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="983 1480 1193 1547">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1193 1480 1394 1547">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="619 1547 778 1594"></td> <td data-bbox="778 1547 983 1594"></td> <td data-bbox="983 1547 1193 1594" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1193 1547 1394 1594"></td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të

Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Sipas RVB dhe sipas aneksit përkatës , ngarkesa e programit të studimit MP në 'Financë' është strukturuar në përmbushje Ligjit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015 si dhe të Udhëzimit Nr 31 të MASR, ku secili nga personeli akademik i angazhuar në program nuk e kalon numrin maksimal të orëve dhe lëndëve gjatë një viti akademik. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor për programin e studimit MP në 'Financë', është 24 orë mësimore 50-minutëshe (standarti sipas VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 deri në 25 orë mësimore 50 minutëshe). Pra ngarkesa javore është në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi. (Anex_III_2_1_Dosja e programit studimit MP_Finance, Kreu VI, VII)
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Sipas RVB , në programin e studimit Master Profesional në 'Financë', organizimi i lëndëve dhe praktikave është bazuar në LAL 80/2015 si dhe në Direktivën 2015/36 EC të Parlamentit Europian dhe KE. Megjithatë, programi i studimit Master Profesional në 'Financë' duhet rishikuar në mënyrë të pjesshme, me qëllim thellimin e njohurive praktike të studentëve dhe mundësi më të mëdha në punësimin e tyre në të ardhmen. Konkretisht, në programet e lëndëve të zhvilluara duhet të përfshihen më tepër raste studimore konkrete, si dhe programe kompjuterikë të njohur, të dobishëm në tregun e punës.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Sipas RVB dhe sipas anekseve përkatës , programet e studimit të Masterit Profesional në 'Financë' janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese janë organizuar në 5 kategori, nga A në E. Kreditet për çdo lëndë mbajnë parasysh ngarkesën në orë mësimore dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti. (Anex_III_1_1_Rregullore Program Studimi_FE_MP_Fin, neni 13) e
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Kohëzgjatja normale e Programit të studimit të Masterit Profesional në 'Financë' është 1 vit akademik (60 kredite) dhe/ose 2 vite akademike (120 kredite). (Anex_III_1_1_Rregullore Program Studimi_FE_MP_Fin, neni 11) e Viti akademik përbehet nga një ngarkesë prej 1500 orësh në auditor dhe jashtë tij ose 60 kredite ECTS. Viti akademik ndahet

	<p>në dy semestra, secili me 25 javë mësimore, 15 javë semestri i parë dhe 10 javë semestri i dytë. Programit të studimit të Masterit Profesional në 'Financë' përmban lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje, secila me provimin përkatës. Në program përfshihet praktika profesionale dhe provimi i përgjithshëm i formimit ose mbrojtja e diplomës.</p> <p>(Anex_III_2_1_Dosja e programit studimit MP_Financë)</p> <p>Sipas RVB, për ngritjen e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës kurrikulare janë shfrytëzuar eksperiencat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në 'Financë' duhet rishikuar në mënyrë të pjesshme, me qëllim thellimin e njohurive praktike të studentëve dhe mundësi më të mëdha në punësimin e tyre në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Përpara hapjes së programeve të studimit të profileve të ndryshme, KUQ kreu një analizë të tregut të punës.</p> <p>(Anex_I_12_Mbi studimin e tregut e punës tetor 2017)</p> <p>Pavarësisht konkluzioneve të rëndësishme të këtij studimi, autorët nuk japin sqarime të detajuara mbi metodologjinë statistikore të përdorur, si dhe mbi statistikën përshkuese të lidhura me kampionët e përdorur.</p> <p>KUQ ofron mundësi për njohjen e krediteve sipas kërkesave për vazhdimin ose transferimin e studimeve, midis të njëjtit cikël, brenda të njëjtit institucion ose në institucione të tjerë brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>(Anex_I_1_Statuti i KUQ Neni 34)</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në çdo program lënde përfshihet përshkrimi përkatës, objektivat, temat, konceptet themelore, përmbajtja, literatura, detyrimet e studentit dhe sistemi i vlerësimit të tij.</p> <p>(Anex_III_2_4_Syllabuse_MP_Finance)</p> <p>Megjithatë, në disa raste të caktuara seksioni i literaturës nuk është i ndarë në kategoritë 'të detyruar' dhe 'ndihmëse', si dhe nuk përfshin tekste të 5 viteve të fundit. Përgjithësisht, kjo pjesë e programeve të lëndëve nuk është e standardizuar në aneksin përkatës.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi i studimit të Masterit Profesional në 'Financë' u jep mundësi studentëve të pozicionohen qartësisht në karrierën e tyre të ardhshme profesionale. Ky program studimi synon që studentët të bëhen të aftë, si nga ana teorike, ashtu edhe nga ana profesionale.</p>
<p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>(Anex_III_1_1_Rregullore Program Studimi FE_MP_Fin)</p>

	<p>Në programet e lëndëve të përfshira në Masterin Profesional në 'Financë' përshkruhen gjithashtu përfitimet përkatëse për studentët. (Anex III 2 4 Syllabuse_MP_Finance)</p> <p>Në RVB dhe në aneksin përkatës theksohet se: Në përmbajtjen e programit të studimit të Masterit Profesional në 'Financë', lëndët përbërëse të tij i japin studentëve dijet, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme që një program i ciklit të dytë synon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Studentët pas përfundimit të programit të studimit kanë fituar aftësi të tilla si të njohin dhe të kuptojnë saktë pasqyrat financiare të një biznesi 2. Të realizojnë analizë të mirëfilltë të pasqyrave financiare 3. Të mundën të auditojnë pasqyrat financiare dhe veprimtarinë e një biznesi 4. Të kuptojnë funksionimin e institucioneve financiare <p>(Anex III 2 2 Programi i studimit_MP_FIN_2016-2018)</p> <p>Nga analiza jonë si GVJ vërejmë një përqëndrim të theksuar të programit në lëndët e kontabilitetit. Kjo përforcohet edhe në paragrafin e mësipërm. Në opinionin tonë, ky fokus në fushën e kontabilitetit nuk justifikohet tërësisht nga emërtimi i masterit, i cili është i përgjithshëm dhe rrjedhimisht do të duhej të përfshinte në mënyrë të barabartë fushat kryesore të financës. Ky fakt u pranua nga stafi akademik i Masterit Profesional në 'Financë' dhe nga titullarët e KUQ (Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Rektori), të pranishëm në takimin me ekspertet e vleresimit në institucion. Ata u angazhuan në korrigjimin e këtij problemi, pra në ndryshimin e mundshëm të emërtimit të masterit (p.sh., 'Financë-Kontabilitet') ose në ndryshimin e pjesës së lëndëve të përfshira në program.</p>								
<p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përpara hapjes së programeve të studimit të profileve të ndryshme, KUQ kreu një analizë të tregut të punës. (Anex I 12 Mbi studimin e tregut e punës tetor 2017)</p> <p>Pavarësisht konkluzioneve të rëndësishme të këtij studimi, autorët nuk japin sqarime të detajuara mbi metodologjinë statistikore të përdorur, si dhe mbi statistikat përshkruese të lidhura me kampionët e përdorur.</p> <p>KUQ ofron mundësi për njohjen e krediteve sipas kërkesave për vazhdimin ose transferimin e studimeve, midis të njëjtit cikël, brenda të njëjtit institucion ose në institucione të tjerë brenda dhe jashtë vendit. (Anex I 1 Statuti i KUQ Neni 34)</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="592 1720 751 1805">Përmbushet</th> <th data-bbox="751 1720 967 1805">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="967 1720 1177 1805">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1177 1720 1415 1805">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="592 1805 751 1850"></td> <td data-bbox="751 1805 967 1850" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="967 1805 1177 1850"></td> <td data-bbox="1177 1805 1415 1850"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X		
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
	X								

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar aneksit I.1.2 të programit të studimit të KUQ, organigramës së Fakultetit FE, numrit të stafit akademik FE 2016-2018, konkluzioneve të nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm si dhe kontrollit në institucion nga ekspertët e vlerësimit, sipas datave të programuara, në zyrën e burimeve njerëzore, në disa raste të veçanta, u evidentuan parregullsi në dosjet personale të personelit akademik efektiv dhe me kontratë të Masterit Profesional në 'Financë'. Më konkretisht, në disa raste u evidentuan mangësi dhe pasaktësi të pjesshme të dokumentave në këto dosje, si për shembull mungesë CV-je, mungesë të pjesshme të diplomave të studimeve universitare. Gjithashtu, gjatë takimit me studentët aktualë të këtij programi u konstatuan në disa raste të veçanta mospërputhje të emrave të stafit akademik mësimdhënës, në krahasim me listën e pedagogëve të aneksit përkatës.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Drejtimesit e KUQ (dekani i Fakultetit të Ekonomisë, rektori), përgjegjësi i zyrës së burimeve njerëzore dhe një pjesë e stafit akademik të Masterit Profesional në 'Financë' u angazhuan maksimalisht për zgjidhjen e këtyre problemeve, konkretisht duke azhornuar sa më shpejt numërin e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të Masterit Profesional në 'Financë' në aneksin përkatës, si dhe duke plotësuar dosjet personale me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Gjithashtu, u konstatua se në Fakultetin e Ekonomisë në KUQ janë të angazhuar 17 anëtarë të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, nga të cilët 11 pedagogë janë pjesë e Departamentit të Financës (DF). Në DF, personel akademik efektiv dhe 7 persona, nga të cilët, të paktën 3 janë personel akademik me grada shkencore dhe tituj akademik, me përvojë në mësimdhënie dhe punë kërkimore, të cilët bashkërendojnë aktivitetin dhe mbështesin kualifikimin edhe të pjesës tjetër të stafit të fakultetit. Si pjesë e stafit me kontratë, DF ka në përbërjen e tij të paktën 4 anëtarë, të gjithë me grada shkencore dhe tituj akademik. Pjesë e fakultetit është edhe Qendra Kërkimore Shkencore, e cila ka 7 anëtarë, nga të cilët 3 janë personel me grada shkencore dhe tituj akademik.</p> <p>Mbështetur në Aneks III_2_3, stafi në këtë program studimi është si më poshtë:</p> <p>6 PAE – 1 Prof Dr; 4 Prof. As; 1 Dr</p>

	<p>2 PAK - 1 Prof Dr; 1 Phd</p> <p>GVJ gjatë takimit në institucion, Ju pohua se staf i angazhuar në këtë program janë 5 të brendshëm dhe 4 të jashtëm. Të dhënat e hedhura në RVB janë gabim. Studentët që ndjekin këtë program janë 3 gjithsej</p> <p>Ngarkesa në orë e këtij stafi si në programin Mp Financë, ashtu edhe në programin Msc Financë rezulton:</p> <p>Për stafin PAE - minimalisht 50 orë (Dr M. R dhe Dr D. K)) maksimalisht 180 orë (Dr M. M)</p> <p>Për stafin PAE të angazhuar edhe në programet e tjera të KUQ Minimalisht 220 orë (Dr Z. P) Maksimalisht 330 orë (Prof As P. L)</p> <p>Ndërkohë, personeli akademik efektiv realizon pjesën më të madhe të ngarkesës mësimore në gjashtë programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë që ka fakulteti. Gjithashtu institucioni ka personel administrativ 3 anëtarë që është në shërbim të punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të të gjithë programeve.</p> <p>Ashtu siç edhe u pohua edhe në takimin me stafin akademik të programit, gjatë vizitës në KU Qiriaz, Dekani i Fakultetit, njëkohësisht edhe staf në këtë program, GVJ ju bë me dije se personeli akademik i brendshëm mbulon 67% të ngarkesës në këtë program. Disa të dhën në RVB janë hedhur gabim, stafi i RVB nuk përputhet me gjendjen faktike. Edhe psë në këtë program janë një numër shumë i vogël i studentëve frekuentues (aktualisht vetëm 3 studentë), Dekani pohoi se si Institucion po punojnë për të rritur këtë ngarkesë nga 67% në 70% të mbuluar nga PAE</p> <p>Sipas aneksit II.1 të Rregullores së FE, neni 16,17,18 dhe Rregullores së departamentit Financë, neni 10,11,12, vihet re se Departamenti i Financës i KUQ ofron programe studimi në fushën e financës, si profesionale, ashtu edhe shkencore. Programet e reja janë në sinkron me nevojat e shoqërisë dhe kushtet ekzistuese të vendit. Programet e studimit organizohen në dy nivele: Ciklin e Parë dhe të Dytë. Departamenti i Financës i KUQ synon të sigurojë njohuri të krahasueshme me institutet analoge universitare jashtë vendit.</p> <p>Mbështetur dhe në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm, konkludojmë së programi i Masterit Profesional në 'Financë' mban numrin 7 të kornizës europiane (dhe shqiptare) të kualifikimit.</p> <p>Duke u bazuar në CV-të e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të Masterit Profesional në 'Financë', përgjithësisht mund të konfirmohet përputhja e karrierës akademike me mësimdhënien në lëndën përkatëse, pjesë e programit të studimit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit të Masterit Profesional në 'Financë' është përgjithësisht</p>
--	---




	në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, si dhe me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Mbështetur në aneksin II.1 të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, neni 6, 11,12,15, Aneksin_II.6 të Rregullores së Departamentit, neni 7,8,19,24; Aneksin_III.1_1 të Rregullores së programit të studimit MP “Financë”, si dhe në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm, theksojmë se institucioni nxit dhe motivon bashkëpunimin e ngushtë të personelit akademik, jo akademik, administrativ dhe studentëve, në përputhje me statutet e tyre, funksionet dhe përgjegjësitë, për arritjen dhe realizimin e qëllimeve institucionale. Gjithashtu, vihet re se, bashkëpunimet brenda KUQ janë në mes fakulteteve, si dhe mes departamenteve të fakultetit Ekonomik. Ajo shprehet në angazhimin e stafit akademik në mësimdhënie për lëndë të veçanta në të dy fakultetet, në organizimin e aktiviteteve kërkimore-shkencore, mbledhjet e përbashkëta, diskutimet për planet e programet mësimore, në plotësimin e nevojave për pasurimin e bazës materiale mësimore dhe didaktike. Sipas listës së bashkëpunimit ndërinstitutional të kolegjit si dhe bazuar në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm, KUQ ka bashkëpunime ndërinstitutionale me një sërë institucioneve shtetërore dhe IAL brenda e jashtë vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës në përgjithësi, duke anagzhuar edhe stafin e nevojshëm. Kryesisht, objektivat e këtyre bashkëpunimeve janë realizimi i praktikave profesionale me studentët sipas profilit, shkëmbimi i përvojave reciproke, krijimi i mundësive të punësimit me kohë të pjesshme të studentëve dhe në profil pas përfundimit të studimeve.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	KUQ angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore dhe laboratorike, pjesë e programit të studimit të Masterit Profesional në ‘Financë’. (Anex_1_11_7_Statistike_per_mjediset_e_KUQ; Anex_II_9_Lista_e_personelit_akademik_Dep_Fin)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

28

<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Sipas RVB, departamenti i Financës kryen në mënyrë periodike konsultime dhe marrin parasysh propozimet nga biznesi privat mbi ndryshimet e tregut të punës. Ata ftojnë vazhdimisht ekspertë të fushës në ambientet e KUQ për të dhënë sugjerimet e tyre apo të rejat e transformimeve të tregut të punës. Këto propozime i shërbejnë për përmirësimin e përmbajtjes së programit.</p> <p>Siç jemi shprehur edhe më sipër, GVJ mendon se Programi i studimit Master Profesional në 'Financë' duhet rishikuar në mënyrë të pjesshme, me qëllim thellimin e njohurive praktike të studentëve dhe mundësi më të mëdha në punësimin e tyre në të ardhmen.</p>				
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>KUQ inkurajon dhe përfshin në diskutime edhe studentët dhe strukturat e tij. Një prej anëtarëve të senatit akademik është përfaqësues i studentëve të KUQ. Gjithashtu, një nga anëtarët e Këshillit të Etikës vjen nga studentët.</p> <p>(Anex I_1 Statuti i KUQ)</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>	<p>Në faqjen zyrtare të KUQ përshkruhet vizioni dhe misioni i Zyrës së Këshillimit të Karrierës. Kjo zyrë synon, midis të tjerash, të orientojë dhe ndihmojë studentët për të bërë zgjedhje të përgjegjshme dhe të qëndrueshme gjatë gjithë jetës, si dhe t'u mundësojë studentëve të arrijnë qëllimet e tyre në drejtim të karrierës së tyre dhe të japin një kontribut pozitiv në komunitet. Studentët kanë gjithashtu mundësi të japin sugjerimet dhe kritikën e tyre në lidhje me programet e studimit.</p> <p>(https://www.qiriazhi.edu.al/studentet/zyra-e-karrieres/)</p>				
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.</p>	<p>KUQ ka bashkëpunime ndërinstucionale me institucione publike e private, njësitë e pushtetit vendor, etj.</p> <p>(Anex I_13 Lista e bashkëpunimit ndërinstucionale Kolegjit)</p> <p>Numri i bashkëpunimeve totale është 19. Ato përfshijnë institucione shtetërore dhe IAL brenda e jashtë vendit (si Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Bashkia Kamëz, Modul University Vienna, etj.), si dhe kompani të ndryshme (Travelbest SRL, Spitali Amerikan, etj.).</p> <p>Sipas RVB, KUQ përditëson në mënyrë të vazhdueshme dhe riorganizon programe në përputhje me vizionin strategjik të zhvillimit të ekonomisë shqiptare duke bashkëpunuar ngushtë me pushtetin vendor dhe institucionet të tjera publike dhe private.</p> <p>Në të ardhmen nevojitet një përshkrim më i qartë dhe i detajuar i këtyre bashkëpunimeve, si dhe i përfitimeve përkatëse për institucionin dhe ekonominë në përgjithësi.</p>				
<table border="1"> <tr> <td data-bbox="614 1854 758 1917">Niveli</td> <td data-bbox="758 1854 949 1917">Përbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="949 1854 1141 1917">Përbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1141 1854 1407 1917">Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>		Niveli	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
Niveli	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
--	--	--	--	----------

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>KUQ ka adaptuar metodat inovative të mësimdhënies, ruajtjes së informacionit, informimit dhe komunikimit. Platforma e të mësuarit në distancë e-learning, e cila aplikohet në KUQ, realizohet duke përdorur aplikacionet elektronike nëpërmjet internetit, rrjetit, apo kompjuterit personal duke shkëmbyer aftësitë dhe njohuritë në mënyrë virtuale. Në faqjen zyrtare të KUQ (www.qiriaz.edu.al) të gjithë kanë mundësinë të njihen me kurrikulën, programet, stafin dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me profilin dhe veprimtarinë e këtij institucioni. Informacioni është i organizuar sipas kategorive përkatëse dhe publikohet në kohë reale. LMS (Learning management system) mundëson menaxhimin e materialit mësimor dhe administrimin e procesit mësimor. 'Moodle', i njohur edhe si Mjedisi Virtual i të Mësuarit (Virtual Learning Environment) është një platformë edukimi ndërkombëtare e cila është përpunuar duke iu përshtatur strukturës së KUQ. Me Moodle është e mundur të publikohen materiale didaktike; të zhvillohen, planifikohen dhe menaxhohen llojet e ndryshme të aktiviteteve të vlerësimit; të menaxhohen komunikimet me përdoruesit. Aktualisht KUQ, ka krijuar dhe përdor platformën e vet 'moodle' në funksion të mësimdhënies, ku personeli akademik dhe studentët kanë akses dhe ndërveprojnë rregullisht.</p> <p>(Anex_I_18 Sistemi Informatik dhe Metodat e Mesimdhënies)</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Sipas RVB dhe anekseve përkatës, monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet në mënyrë periodike. Në KUQ realizohet dy herë në vit një pyetësor me studentët. Ky pyetësor analizohet me qëllim vlerësimin e zhvillimit të programit mësimor.</p> <p>(Anex_II_12 Pyetsoret per studentet FE_2017_2018; Anex_II_6_Rregullore e Departamentit të Financës, Neni 24)</p> <p>Studentët kanë të drejtë të ankohen për rezultatin e provimit. Ankesa depozitohet në Departament dhe pedagogu është i detyruar të kthejë përgjigje brenda dites pasardhëse.</p> <p>(Anex_II_1_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>NJSBC (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë) përqëndrohet, midis të tjerash, në zbatimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësim dhe</p>

	<p>përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënies, evidentimin dhe përcjelljen e problemeve për zgjidhje.</p> <p>NJSBC monitoron procesin e vlerësimit të mësimdhënies, hulumton modele të ndryshme, vlerëson dhe publikon veprimtaritë e lidhura me vlerësimin e shërbimeve akademike dhe administrative, etj.</p> <p>(Anex I 5 1 Rregullore e NJSBC)</p>								
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC harton në mënyrë periodike raportin e ‘Vetëvlerësimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë’ bazuar në Standardet Shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve në KUQ. Raporti prezantohet në Senatit e KUQ, i cili e analizon dhe përcakton zgjidhjen e problemeve përkatëse. Vendimet e Senatit reflektohen në Planin Strategjik të zhvillimit të KUQ.</p> <p>(Anex I 5 1 Rregullore e NJSBC-se, neni 14)</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në institucion, pedagogu njihet me rezultatet e anketimit, ku përfshihen komentet, sugjerimet apo aprovimet e studenteve. Rezultatet e anketimit janë të një rëndësie të veçantë edhe për vetë organet drejtuese të institucionit, të cilat inkurajojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Të dhënat e pyetësorëve hidhen në databazë në Excel dhe përpunohen. Rezultatet e pyetësorëve sipas kurseve të marra paraqiten në një raport të bërë nga Departamenti dhe më pas edhe në raportin e Dekanatit.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi III.2</p> <p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në Fakultetin e Ekonomisë në KUQ format kryesore të punës mësimore janë leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat me shkrim, projektet dhe detyrat e kursit, temat e diplomës dhe provimi i formimit.</p> <p>(Anex II 1 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, neni 51)</p> <p>Viti akademik përbehet nga një ngarkesë prej 1500 orësh në auditor dhe jashtë tij ose 60 kredite ECTS. Viti akademik ndahet në dy semestra, secili me 25 javë mësimore, 15 javë semestri i parë dhe 10 javë semestri i dytë. Programit të studimit të Masterit Profesional në ‘Financë’ përmban lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje, secila me provimin përkatës.</p>

Në program përfshihet praktika profesionale dhe provimi i përgjithshëm i formimit ose mbrojtja e diplomës.
(Anex_III_2_1_Dosja e programit studimit MP_Financë)

Në planin mësimor parashikohen të gjitha lëndët të cilat zhvillohen gjatë secilit semestër me kreditet dhe orët e ngarkesave përkatëse.

(Anex_III_2_2 Programi i studimit MP_FIN_2016-2018)

Në aneksin përkatës janë paraqitur gjithashtu kreditet sipas veprimtarive formuese.

(Anex_III_2_1_Dosja e programit studimit MP_Finance)

GVJ nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur në DVV si ai i dorëzuar para ndërprerjes së procedurës për shkak të mos përmbushjes së detyrimit ligjor për plotësimin e numrit të stafit të brendshëm në njësitë bazë, ashtu edhe dokumentacioni i dorëzuar pas rifillimit të procedurës, vëren se:

Plani mësimor i paraqitur për të tre vitet akademike (2016-2017; 2017-2018 dhe 2018-2019) nuk i ka të detajuara orët e leksioneve dhe të seminareve për cdo lëndë.

GVJ për të nxjerrë sa janë orët e leksioneve dhe seminareve për vitin aktual 2018-2019, ka parë të gjitha syllabuset e lëndëve të paraqitura në Aneksin_III_2_4 – Syllabuset e lëndëve. GVJ konstaton se kreditet e deklaruar në syllabuse nuk përkojnë më kreditet e deklaruar në planin mësimor për 3 nga 4 lëndët e vitit të , semestri i dytë dhe konkretisht:

Lënda:

1. “Kontabiliteti Financiar i avancuar” është paraqitur me 5 ECTS në planin mësimor 2018-2019, ndërsa në syllabus janë të parashikuara 6 ECTS
2. “Menaxhimi i riskut financiar” është paraqitur me 5 ECTS në planin mësimor 2018-2019, ndërsa në syllabus janë të parashikuara 6 ECTS
3. “Analizë Financiare e” është paraqitur me 4 ECTS në planin mësimor 2018-2019, ndërsa në syllabus janë të parashikuara 6 ECTS

Gjithsej plani mësimor përfshin 9 lëndë të detyrueshme (5 lëndë në semestrin e parë dhe 4 lëndë në semestrin e dytë). Në semestrin e dytë janë të përfshira edhe Praktika mësimore me 4 kredite dhe Provimi i përgjithshëm me 7 kredite.

Për 9 lëndët, referuar syllabuseve, rezulton se zhvillohen 270 orë leksione dhe 260 orë seminare. Për 8 lëndë paraqiten 30 orë leksion dhe 30 orë seminar, ndërsa për një lëndë (Vlerësimi iNdërmarrjeve) paraqiten 30 orë leksion dhe 20 orë seminar.

Sipas përgjegjëses së Departamentit, programi zhvillohet 15 javë në semestrin e parë dhe 10 javë në semestrin e dytë. Në semestrin e dytë janë të përfshira edhe Praktika dhe tema e diplomës.

	Auditorët e KUQ janë të pajisur me mjetet të teknologjisë së informacionit, si projektorë e kompjuter, të domosdoshëm për mësimdhënien.
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Sipas RVB , në programin e studimit Master Profesional në 'Financë', në zbatim të rregullores, personeli akademik dhe ndihmës akademik angazhohet në procesin mësimor duke iu përgjigjur diversitetit të studentëve dhe nevojave të tyre. Megjithatë kjo nuk është e reflektuar qartë në syllabuset e lëndëve, konkretisht në seksionin e 'formës së kontrollit të dijeve'. (Anex_III_2_4_Syllabuse_MP_Finance)
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Në KUQ planifikohet midis të tjerash, të organizohen diskutime me pedagogët e rinj dhe ata me përvojë shumëvjeçare për didaktikën në mësimdhënie dhe mësimnxënie; të organizohen leksione e diskutime të hapura për problemet psikologjike të moshës studentore që sapo kanë mbaruar shkollën e mesme; të organizohen leksione të hapura me studentët nga pedagogët me përvojë të Kolegjit ku të marrin pjesë stafi akademik; të organizohen shkëmbime përvojë në seminare në mes pedagogëve për përgjithësimin e metodave inovative. (Anex_I_7_1_Udhezim per kualifikimin e stafit akademik; Anex_I_5_Manuali i Cilesise KUQ) Sipas RVB , KUQ ju ofron pedagogëve mundësinë e kualifikimit të mëtejshëm duke i lehtësuar nga ngarkesa mësimore në momentin që ata kanë përmbytur me sukses të gjitha detyrimet doktorale në vitet paraardhëse dhe janë në vitin e fundit të doktoraturës. KUQ duhet t'u mundësojë pedagogëve financiarisht zhvillimin e më tepër aktiviteteve shkencore në të ardhmen, si konferenca, shkolla verore, shkëmbime të ndryshme, etj.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Referuar aneksit I.1.2 të programit të studimit të KUQ, organigramës së Fakultetit FE, numrit të stafit akademik FE 2017-2019, konkluzioneve të nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm si dhe kontrollit në institucion nga ekspertët e vlerësimit, sipas datave të programuara, në zyrën e burimeve njerëzore, në disa raste të veçanta, u evidentuan parregullsi në dosjet personale të personelit akademik efektiv dhe me kontratë të Masterit Profesional në 'Financë'. Më konkretisht, në disa raste u evidentuan mangësi dhe pasaktësi të pjesshme të dokumentave në këto dosje, si për shembull mungesë CV-je, mungesë të pjesshme të diplomave të studimeve universitare. Gjithashtu, gjatë takimit me studentët aktualë të Masterit Profesional në 'Financë' u konstatuan në disa raste të veçanta mospërputhje të emrave të stafit akademik

	<p>mësimdhënës, në krahasim me listën e pedagogëve të aneksit përkatës.</p> <p>Ndërkohë, personeli akademik efektiv realizon pjesën më të madhe të ngarkesës mësimore në gjashtë programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë që ka fakulteti. Në këtë program studimi, sic e kemi shprehur edhe më sipër, personeli akademik i brendshëm mbulon 67% të ngarkesës. Gjithashtu institucioni ka personel administrativ 3 anëtarë që është në shërbim të punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të të gjithë programeve. Gjatë vizitës së ekspertëve, nga takimet me stafin dhe studentët, u konstatua se personeli akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas lëndëve përkatëse, të tilla, si punë laboratorike, prezantime në poëer point apo raste studimore.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në mbështetje të rregullores së NJSBC si dhe rregullores së departamentit të financës, u konstatua se monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet në mënyrë periodike.</p> <p>Referuar aneksit II.12 të pyetësorit për studentët FE 2017-2018, në KUQ realizohet dy herë në vit një pyetësor me studentët. Ky pyetësor analizohet me qëllim vlerësimin e zhvillimit të programit mësimor.</p> <p>Mbështetur në rregulloren e fakultetit, studentët kanë të drejtë të ankohen për rezultatin e provimit. Ankesa depozitohet në Departament dhe pedagogu është i detyruar të kthejë përgjigje brenda ditës pasardhëse.</p> <p>NJSBC (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë) përqëndrohet, midis të tjerash, në zbatimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësim dhe përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënies, evidentimin dhe përcjelljen e problemeve për zgjidhje.</p> <p>NJSBC monitoron procesin e vlerësimin të mësimdhënies, hulumton modele të ndryshme, vlerëson dhe publikon veprimtaritë e lidhura me vlerësimin e shërbimeve akademike dhe administrative, etj.</p> <p>Referuar aneksit I.5.1 të rregullores së NJSBC, u evidentua se NJSBC harton në mënyrë periodike raportin e 'Vetëvlerësimin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë' bazuar në Standardet Shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve në KUQ. Raporti prezantohet në Senatin e KUQ, i cili e analizon dhe përcakton zgjidhjen e problemeve përkatëse. Vendimet e Senatit reflektohen në Planin Strategjik të zhvillimit të KUQ.</p> <p>Në vijim të konkluzioneve të nxjerra nga raporti i vlerësimin të brendshëm si dhe të aneksit II të pyetësorit të studentëve, u konstatua se pedagogu njihet me rezultatet e anketimit, ku</p>

	përfshihen komentet, sugjerimet apo aprovimet e studenteve. Rezultatet e anketimit janë të një rëndësie të veçantë edhe për vetë organet drejtuese të institucionit, të cilat inkurajojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Rezultatet e pyetësorëve sipas kurseve të marra paraqiten në një raport të bërë nga Departamenti dhe më pas edhe në raportin e Dekanatit.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Sipas RVB dhe në bazë të konkluzioneve të nxjerra nga takimi i ekspertëve me një pjesë të stafit akademik të Masterit Profesional në 'Financë', personeli akademik dhe ndihmës akademik përdor metoda interaktive të mësimdhënies. Në mënyrë konstante, pedagogët përpiqen të tërhiqet vëmendja e studentëve me pyetje të ndryshme, në mënyrë që leksioni të jetë sa më i kuptueshëm. Në këtë mënyrë, studentët angazhohen në debate, shkëmbim njohurish dhe eksperiencash. Gjithashtu, studentët janë ftuar të bashkëpunojnë me departamentet për gjenerimin e ideve dhe trajtimin e tyre në formën e punimeve në seanca brain-storming.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Studentët e KUQ dhe veçanërisht studentët e Masterit Profesional në 'Financë' kanë në dispozicion hapësira të mjaftueshme dhe cilësore për zhvillimin e procesit mësimor dhe shkencor, të cilat janë të pastra dhe të rregullta. Godina e KUQ përmban midis të tjerash: tri salla për leksione, shtatë klasa për seminare, laboratorin e informatikës, si dhe një sallë informatike, e cila shërben dhe si sallë interneti. (Anex_I_11_6_planimetria e tri kateve ku behet mesim;) Anex_1_11_7_Statistike per mjediset e Kolegjit Universitar) Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në institucion, mirëmbajtja e ambientit të institucionit kryhet në mënyrë të vazhdueshme nga dy sanitare dhe një teknik. Sanitaret kanë për detyrë mbajtjen e ambjenteve pastër, ndërsa tekniku është përgjegjës për menaxhimin e problemeve teknike, duke filluar këtu që me problemet e ajrit të kondicionuar nëpër klasa e zyra e duke vazhduar me problemet elektrike dhe hidraulike.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të	Sipas RVB dhe anekseve përkatës, KUQ, nëpërmjet Ekspertit Vlerësues dhe Relacionit të Verifikimit të Godinës

<p>pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>hartuar prej tij, konfirmon përmbushjen e kërkesave ligjore dhe garanton të gjitha kapacitetet dhe mjediset e nevojshme për realizimin e të gjithë programeve të studimit. Përgjithësisht, ambientet e KUQ, të dedikuara për procesin mësimor, janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave. Në sallat e dedikuara për leksion/seminar gjenden të gjithë elementët e nevojshëm për një zhvillim normal të procesit mësimor (banka, dërrasa, video-projektor, kondicioner etj.) (Anex_1_11_7_Statistike per mjediset e KUQ)</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Bazuar në Udhëzuesin në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit, u konstatua se KUQ ka adaptuar sisteme të ndryshme të ruajtjes së informacionit, informimit dhe komunikimit. Platforma e të mësuarit në distancë e-learning, e cila aplikohet në KUQ, realizohet duke përdorur aplikacionet elektronike nëpërmjet internetit, rrjetit, apo kompjuterit personal duke shkëmbyer aftësitë dhe njohuritë në mënyrë virtuale.</p> <p>Në faqjen zyrtare të KUQ (www.qiriaz.edu.al) të gjithë kanë mundësinë të njihen me kurrikulën, programet, stafin dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me profilin dhe veprimtarinë e këtij institucioni. Informacioni është i organizuar sipas kategorive përkatëse dhe publikohet në kohë reale.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka e KUQ numëron disa qindra tituj bibliografikë të hedhur në Excel sipas kategorive. Ato shërbejnë si literaturë për të gjitha programet e studimit që ofron KUQ. Biblioteka ka si mision mbështetjen e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>(Anex I 2 Plani Strategjik i Zhvillimit të Kolegjit Universitar ‘Qiriaz’ d) Sherbimi i Bibliotekes)</p> <p>GVJ shprehet se: Pavarësisht ambienteve komode, të rregullta dhe të përshtatshme, biblioteka duhet të pasurohet më tepër me periodikë dhe revista të ndryshme, libra të lidhur veçanërisht me fushën e financës, etj.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB, platforma Moodle e përdorur nga KUQ, mundëson përdorimin e modulit të bibliotekës (‘Exabis Library’). Në këtë modul kanë akses vetem përdoruesit e kësaj platforme. KUQ ofron gjithashtu informacion mbi platformat online nga ku personeli akademik dhe studentët mund të aksesojnë në mënyrë të pavarur dhe pa kosto shtesë materiale të nevojshme gjatë procesit mësimor. Platforma që përdoret më gjërë nga KUQ është platforma ‘Questia’ (www.questia.com), e cila përmban librarinë online, mjetet e citimit dhe librarisë, foldera projektesh, qendrën e shkrimit si dhe u jep përdoruesve mundësinë të publikojnë punimet e tyre shkencore.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

37

	Biblioteka dhe libraria online duhet të pasurohen më tepër me periodikë dhe revista të ndryshme, libra të lidhur veçanërisht me fushën e financës, etj.			
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Studentët e KUQ dhe veçanërisht studentët e Masterit Profesional në 'Financë' kanë në dispozicion laboratorin e informatikës, si dhe një sallë informatike, e cila shërben dhe si sallë interneti. (Anex_I_11_6_planimetria e tri kateve ku behet mesim; Anex_1_11_7_Statistike per mjediset e Kolegjit Universitar)			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma online (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Bazuar në Udhëzuesin në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit, u konstatua se KUQ ka adaptuar sisteme të ndryshme të ruajtjes së informacionit, informimit dhe komunikimit. Platforma e të mësuarit në distancë e-learning, e cila aplikohet në KUQ, realizohet duke përdorur aplikacionet elektronike nëpërmjet internetit, rrjetit, apo kompjuterit personal duke shkëmbyer aftësitë dhe njohuritë në mënyrë virtuale.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Sipas RVB dhe faqeje elektronike përkatëse, platforma online e quajtur 'Portali i Studentit' u mundëson të gjithë pedagogëve dhe studentëve komunikim të brendshëm, të shpejtë dhe të sigurtë. (https://aula.qiriaz.edu.al/;) Komunikimi midis stafit akademik të institucionit realizohet përmes një grupi të veçantë të emëruar 'Stafi Akademik' (Komunikim i Brëndshëm). Në këtë grup stafi akademik ka akses në të gjitha rregulloret, udhëzuesit, syllabuset, kurrikulat e programeve të studimit apo dokumentacione të tjera të nevojshme.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Diplomimi për studentët e Masterit Profesional në 'Financë' bëhet me provim përfundimtar ose me punim diplome. Kjo vendoset nga studenti. Departamenti i Financës përcakton listën e temave të diplomave, duke u mbështetur në fushat përkatëse të studimit. Drejtuesit e temave të diplomave miratohen nga përgjegjësi i Departamentit të Financës. (Anex_II_6_Rregullore e Departamentit të Financës, Neni 49) Departamentet listojnë paraprakisht studentët që planifikojnë të diplomohen. Temat e diplomës përgatiten nga një student ose nga një grup prej 2 studentësh. Temat udhëhiqen nga punonjësit mësimor-shkencor të fakultetit që kanë titull ose gradë shkencore, si dhe nga shkencëtarë të huaj të fushës. (Anex_II_1_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Neni 84)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në KUQ funksionon NJSBC, objektivi i së cilës është, midis të tjerash, zhvillimin e cilësisë, ngritjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, aplikimin, zhvillimin dhe vlerësimin e tij, miratimin e treguesve të cilësisë në kuadër të periudhës të vlerësimit të jashtëm dhe procesit të akreditimit, si dhe kryerjen e të gjitha përgatitjeve të nevojshme gjatë këtij procesi. (Anex_I_5_1_Rregullore e NJSBC-se)</p> <p>Sipas RVB dhe anekseve përkatës, Fakulteti i Ekonomisë dhe departamentet e KUQ dorëzojnë në Rektorat të çdo fund viti akademik, një raport vjetor, i konceptuar si një model i vlerësimit të brendshëm të njësisë. KUQ dorëzoi Raportin Vjetor të Veprimtarisë (2017-2018) të hartuar nga Rektorati, të miratuar nga Senati Akademik i Kolegjit dhe Bordi i Administrimit, që i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë. Ky raport synon të paraqesë në mënyrë sintetike veprimtarinë vjetore mësimore shkencore, edukative si dhe punën e bërë për sigurimin e brendshëm të cilësisë në këtë institucion të arsimit të lartë, bazuar në kuadrin ligjor ekzistues. (Anex_I_15_1_raportit vjetor 2017-2018.pdf)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në KUQ, Departamenti i Financës në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë organizojnë në mënyrë periodike leksione të hapura (nga lektorë vendas dhe të huaj). Sipas RVB, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financës mbështet zhvillimin e mësimdhënies me metodat më të fundit, siç mund të jenë përdorimi i projektorëve, leksioneve të prezantuara në powerpoint.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Metodat më të fundit të mësimdhënies nuk janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me përdorimin e projektorëve dhe leksioneve të prezantuara në powerpoint. KUQ në përgjithësi dhe stafi akademik i Masterit Profesional në 'Financë' në veçanti, duhet të përqëndrohen më tepër në implementimin e software-ve modernë në shumicën e lëndëve që ofrohen.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Sipas RVB, në tërësinë e aktiviteteve të KUQ një vend të rëndësishëm zë rritja e vazhdueshme e nivelit kërkimor-shkencor të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit dhe përfshirja e tyre në projekte të ndryshme të</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p></p>

<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>sipërmarrjeve private, institucioneve shtetërore dhe organizmave ndërkombëtare.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Pavarësisht CV-ve kryesisht të pasura të stafit akademik të Masterit Profesional në 'Financë', KUQ duhet t'u mundësojë atyre financiarisht zhvillimin e më tepër aktiviteteve shkencore në të ardhmen, si konferenca, shkolla verore, shkëmbime të ndryshme, etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në kreun 7 të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë të KUQ përshkruhen format e kontrollit të dijeve të studentëve. Midis të tjerash, specifikohet se format bazë të kontrollit të dijeve janë provimet. Mënyra e kontrollit të dijeve përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit. Kontrolli i dijeve realizohet në dy faza: gjatë procesit mësimor dhe në provimin përfundimtar.</p> <p>Në programet e lëndëve të Masterit Profesional në 'Financë' specifikohet për secilën lëndë mënyra e vlerësimit, pjesët përbërëse të tij me përqindjet dhe sqarimet përkatëse. (Anex II 1 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; Anex III 2 4 Syllabuse MP Finance)</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në KUQ, pedagogu i secilës lëndë, javën a parë të mësimit bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat, temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të</p>	<p>Kontrolli i dijeve realizohet në dy faza: gjatë procesit mësimor dhe në provimin përfundimtar. Gjatë kontrollit mësimor, kontrolli i dijeve realizohet përmes pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentit në leksione, seminare, ushtrime, punë laboratorike, detyrat me shkrim, detyrat/projektet e kursit, praktikë mësimore, etj. Provimi është formë kryesore kontrolli për vlerësimin e</p>

demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një moduli. Provimi zhvillohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar, sipas gjykimit të pedagogut dhe miratimit të departamentit.</p> <p>Në programet e lëndëve të Masterit Profesional në 'Financë' specifikohet në çdo rast mënyra e vlerësimit, pjesët përbërëse të tij me përqindjet dhe sqarimet përkatëse.</p> <p>(Anex II 1 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; Anex III 2 4 Syllabuese MP Finance)</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	<p>Kontrolli i dijeve realizohet në dy faza: gjatë procesit mësimor dhe në provimin përfundimtar. Vlerësimi final për çdo student është një mesatare e ponderuar e vlerësimeve të të dy fazave. Gjithashtu, studentët zhvillojnë detyra kontrolli, të cilat organizohen javën e tetë të çdo semestri, mbi bazë grupi mësimor dhe vetëm gjatë orëve të planifikuara për seminare.</p> <p>(Anex II 1 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; Anex III 2 4 Syllabuese MP Finance; Anex I 3 Rregullore e KUQ)</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në institucion, KUQ zhvillon testime online, sipas kriterëve të parapercaktuara nga pedagogu i lëndës, duke bërë të mundur realizimin e një testimi transparent dhe objektiv. Sistemi llogarit në mënyrë elektronike, në kohë reale, menjëherë pas përfundimit të provimit, vlerësimin në pikë për secilin student. Testimi i njohurive përmes kësaj forme mundësohet nga platforma e-learning.</p>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	<p>Provimi zhvillohet nëpërmjet tezave të provimit, të cilat hartohen nga titullari/pedagogu i modulit së bashku me asistentit e tij (nëse ka) dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit. Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve, pranë Fakultetit të Ekonomisë ngrihet Komisioni i Provimeve të Fakultetit. Nëse njëri nga pedagogët nuk mund të marrë pjesë në provim, ose kur përgjegjësi i departamentit e gjykon, ai përcakton pedagogun që do ta zëvendësojë. Në rast pamundësie zëvendësimi, me propozim të dekanit dhe miratim të rektorit, provimi shtyhet jashtë sezonit brenda 5 ditëve nga përfundimi i tij.</p> <p>(Anex II 1 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, neni 61; Anex I 3 Rregullore e KUQ)</p>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet	<p>Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në institucion, provimet zhvillohen në mënyrë anonime me</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	sekretim. Provimet zhvillohen në ambiente të posaçme dhe të përshtatshme për realizimin e tyre. Ato monitorohen nga Komisioni i Provimit.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në institucion, pedagogu i secilës lëndë, javën e parë të mësimit bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat, temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit. Studentët informohen dhe këshillohen vazhdimisht, me qëllim përmirësimin e ecures së tyre.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Anëtarët e komisionit të provimit mbikëqyrin gjatë gjithë kohës për zhvillimin korrekt të provimit. Studenti vlerësohet mbetës kur kopjon ose mashtron me mjete ndihmëse jo të lejueshme (në këtë rast ai përjashtohet nga provimi). (Anex II 1 Rregullore e Fakultetit të Ekonomise, nenet 63,65)
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në të gjitha format e provimit përdoret edhe sistemi i vlerësimit me pikë, vlera përkatëse detyrimisht konvertohet në notë sipas rregulloreve përkatëse. Rezultatet e provimit u bëhen të njohura studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë, dhe për provimet me shkrim, pas korrigjimit të tyre. Studenti i merr rezultatet e provimit për modulën përkatës në faqjen zyrtare të KUQ. Pikët e vlerësimit gjatë vitit u komunikohen studentëve gjatë orës së fundit të mësimit. Rezultatet paraprake të provimit hidhen në sistem brenda ditës kur provimi është me gojë dhe brenda 5 ditëve punë kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe me gojë. (Anex I 3 Rregullore e KUQ; Anex II 6 Rregullore e Departamentit të Financës ; Anex II 1 Rregullore e Fakultetit të Ekonomise, neni 64)
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Rezultatet e provimit u bëhen të njohura studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë ose pas korrigjimit të tyre, në rast të provimeve me shkrim. Studenti i merr rezultatet në faqjen zyrtare të KUQ. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake të provimit studentët kanë detyrimin e leximit të notës përkatëse në sistem dhe të kontestimit të mundshëm brenda dy ditëve (48 orëve). Në të kundërt nota konsiderohet përfundimtare.
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Pas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni bën mbyllje të procesverbalit, dorëzim në sekretari, dhe hedhjen në sistem të vlerësimit brenda dy ditëve. Në raste të jashtëzakonshme mbas afatit ligjor (maksimumi 7ditë nga dita e provimit) komisioni i paraqet një kërkesë me shkrim përgjegjësit të departamentit përkatës për ndryshimin e notës të pretenduar dhe me miratimin e dekanit të Fakultetit të Ekonomisë korrigjohet nota në sistem nga IT-ja e fakultetit.

	<p>Studenti ka të drejtë të ankohet te Përgjegjësi i Departamentit dhe për dijeni te Dekani, me shkrim, brenda ditës së zhvillimit të provimit (për parregullsi gjatë zhvillimit të provimit) dhe në momentin e marrjes së përgjigjes së vlerësimit (për kontestim në lidhje me vlerësimin). Pas kësaj ankese, pedagogu përkatës është i detyruar të kthejë përgjigje, maksimumi brenda ditë së nesërme.</p> <p>(Anex_I_3_Rregullore e KUQ, neni 64; Anex_II_1_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, neni 64; Anex_II_6_Rregullore e Departamentit të Financës, neni 32-35;)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Pa përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Mbështetur dhe në rregulloren e programit të studimit, kurrikula e programit Master Profesional në “Financë”, ka si mision thellimin e njohurive dhe zhvillimit të aftësive profesionale të studentëve në fushën e financës dhe kontabilitetit. Gjithashtu, ky program përmban lëndë të tilla si: Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit, apo Metodatat e Kërkimit, të cilat synojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit. Programi nuk përmban lëndë në gjuhë të huaj.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në kreun 7 të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë të KUQ përshkruhen format e kontrollit të dijeve të studentëve. Midis të tjerash, specifikohet se format bazë të kontrollit të dijeve janë provimet. Mënyra e kontrollit të dijeve përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit. Kontrolli i dijeve realizohet në dy faza: gjatë procesit mësimor dhe në provimin përfundimtar. Në programet e lëndëve të Masterit Profesional në ‘Financë’ specifikohet për secilën lëndë mënyra e vlerësimit, pjesët përbërëse të tij me përqindjet dhe sqarimet përkatëse. Provimi është formë kryesore kontrolli për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një moduli. Provimi zhvillohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar, sipas gjykimit të pedagogut dhe miratimit të departamentit.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe	Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në institucion, në javën e fundit të semestrit studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final.

orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Referuar rregullores së fakultetit, rregullores së departamentit të financës, rregullores së NJSBC si dhe leksioneve të hapura me pedagogë të huaj, evidentohet se Departamenti i Financës në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë organizojnë në mënyrë periodike leksione të hapura jashtë strukturës së përogramit të studimit. Programi i studimit, sipas syllabuseve të lëndëve ka të përcaktuara kompetencat specifike që synohen të arrihen gjatë mësimdhënies.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në institucion, personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instruktin grupin e studentëve në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Gjithashtu, KUQ nxit bashkëpunimin shkencor dhe mësimor midis anëtarëve të stafit akademik për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Referuar aneksit I.15 të raportit vjetor të kolegjit si dhe rregullores së NJSBC, theksojmë se në KUQ është ngritur NJSBC, objektivi i së cilës është, midis të tjerash, zhvillimi i cilësisë, ngritja e sistemit të kontrollit të brendshëm, aplikimi, zhvillimi dhe vlerësimi i tij, miratimi i treguesve të cilësisë në kuadër të periudhës të vlerësimit të jashtëm dhe procesit të akreditimit. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financës mbështet zhvillimin e mësimdhënies me metoda inovative, siç mund të jenë përdorimi i projektorëve, leksioneve të prezantuara në powerpoint.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Megjithatë, metodat më të fundit të mësimdhënies nuk janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me përdorimin e projektorëve dhe leksioneve të prezantuara në powerpoint. KUQ në përgjithësi dhe stafi akademik i Masterit Profesional në 'Financë' në veçanti, duhet të përqëndrohen më tepër në implementimin e software-ve modernë në shumicën e lëndëve që ofrohen. Bazuar në të dhënat e plota të aktiviteteve për kërkimin shkencor të stafit akademik në 3 vitet e fundit si dhe në CV-n e stafit akademik të programit të studimit, vihet re se në tërësinë e aktiviteteve të KUQ një vend të rëndësishëm zë rritja e vazhdueshme e nivelit kërkimor-shkencor të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit dhe përfshirja e tyre në projekte të ndryshme të sipërmarrjeve private, institucioneve shtetërore dhe organizmave ndërkombëtare. Stafi akademik synon të bashkëpunojë me studentët në punime të përbashkëta shkencore. Pavarësisht CV-ve kryesisht të pasura të stafit akademik të Masterit Profesional në 'Financë', KUQ duhet t'u mundësojë atyre, si dhe studentëve financiarisht zhvillimin e me tepër
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	


	aktiviteteve shkencore ne të ardhmen, si konferenca, shkolla verore, shkëmbime të ndryshme, etj..			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi III.8				
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	<p>KUQ ka bashkëpunime ndërinstucionale me një sërë institucionesh shtetërore dhe IAL brenda e jashtë vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës në përgjithësi.</p> <p>(Anex I_13_Lista e bashkëpunimit ndërinstucionale Kolegjit)</p>			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	<p>Praktikat profesionale zhvillohen në institucione, ndërmarrje shtetërore ose private sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe drejtohet nga pedagogu përkatës.</p> <p>(Anex III_1_2_Rregullore e Praktikës Profesionale për FE, Neni 5)</p>			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	<p>Në përputhje me specifikat e planit të studimeve, Departamenti i Financës në KUQ harton programin e praktikës profesionale dhe cakton pedagogët që do të drejtojnë zhvillimin e praktikës në objekt. Me përfundimin e praktikës profesionale, studenti paraqet në departament vërtetimin e kryerjes së praktikës dhe relacionin përmbledhës të saj. Vlerësimi i praktikës bëhet me cilësimin 'fiton' ose 'nuk fiton'. Në rast të vlerësimit 'nuk fiton', studentit i caktohen detyra konkrete për përmbushjen e qëllimeve të praktikës. Shlyerja e detyrimit të praktikës profesionale bëhet në afatin e përcaktuar nga departamenti dhe miratohet nga dekani.</p> <p>Praktika profesionale ekuivalentohet me 4 ECTS.</p> <p>(Anex II_6_Rregullore e Departamentit të Financës, Kreu VI; Anex III_2_2_Programi i studimit MP FIN 2016-2018)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Standardi III.9

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Diplomimi për studentët e Masterit Profesional në ‘Financë’ bëhet me provim përfundimtar ose me punim diplome. Kjo vendoset nga studentit.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>(Anex II_6_Rregullore e Departamentit të Financës, Neni 49)</p> <p>Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në institucion, procedurat e posaçme lidhur me provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës bëhen publike për të gjithë studentet pranë Sekretarisë Mësimore. Informacioni i detajuar mbi procedurat e diplomimit ofrohet nga institucioni në formë të shkruar dhe publikohet gjithashtu në faqen e tij zyrtare.</p>
	<p>Departamentet listojnë paraprakisht studentët që planifikojnë të diplomohen. Temat udhëhiqen nga punonjësit mësimor-shkencor të fakultetit që kanë titull ose gradë shkencore, si dhe nga shkencëtarë të huaj të fushës.</p> <p>(Anex II_1_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Neni 84)</p>
	<p>Diplomimi i studenteve të MP në ‘Financë’ bëhet gjatë muajit Shtator. Afati i diplomimit vendoset nga Dekani i Fakultetit dhe shpallet nga Sekretaria Mësimore një muaj përpara. (Anex II_6_Rregullore e Departamentit të Financës, Kreu VII; Anex II_17_Kërkesat për përgatitjen e punimit të Diplomës; Anex I_3_Rregullore e KUQ)</p> <p>Departamenti përkatës, Sekretaria Mësimore e KUQ dhe gjithë pedagogët udhëheqës asistojnë studentet gjatë procesit të diplomimit. (Anex II_1_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Kreu IX, Neni 82, Neni 83, Neni 84; Anex II_6_Rregullore e Departamentit të Financës, Neni 18, Neni 49, Neni 50, Neni 51;)</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në institucion, programi i provimit të formimit është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit të Ekonomisë. Programi shpallet, në website-n e Kolegjit Universitar ‘Qiriazi’, dhe u bëhet i ditur studenteve, sipas programit të studimit.</p>

<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Departamenti i Financës përcakton listën e temave të diplomave, duke u mbështetur në fushat përkatëse të studimit. Koordinatori i Masterit Profesional në 'Financë' është në mbështetje të punës të përgjegjës të departamentit dhe menaxhon administrativisht gjithë veprimtarinë e këtij programi në Fakultet. Koordinatori, midis të tjerash, të këshillojë studentët për punimin e diplomës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Fusha e studimit, problemi kërkimor dhe formulimi i temës, mund të përcaktohen nga vetë studenti ose / dhe në konsultim me udhëheqësin përkatës. Pas përzgjedhjes së fushës së studimit, problemit kërkimor dhe formulimit të temës së studimit, studenti harton së bashku me udhëheqësin një skedul që përfshin të gjitha hapat, nga fillimi deri në përfundimin e punimit.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>(Anex II_6_Rregullore e Departamentit të Financës, Neni 49; Anex III_1_1_Rregullore e Program Studimi_FE_MP_Fin, Neni 7 pika c; Anex II_17_Kërkesat për përgatitjen e punimit të Diplomës)</p> <p>Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në institucion, studentëve ju vihen në dispozicion mjediset e Kolegjit si dhe të institucioneve të tjera publike apo private me të cilat KUQ ka marrëveshje, me qëllim mbështetjen e punës së tyre kërkimore. Shpenzimet lidhur me realizimin e temës së diplomës i merr përsipër studenti, ndërsa institucioni ka për detyrë t'i ofrojë bazën e materialeve.</p> <p>Temat udhëhiqen nga punonjësit mësimor-shkencor të fakultetit që kanë titull ose gradë shkencore, si dhe nga shkencëtarë të huaj të fushës. Studenti dorëzon në departament tri kopje të printuara të temës së punimit të diplomës (dhe në format elektronik). Një kopje i jepet udhëheqësit që bënë vlerësimin e saj, një kopje recensentit dhe një kopje qëndron në departament për anëtarët e komisionit të mbrojtjes. Udhëheqësi dhe recensenti dorëzojnë në departament vlerësimet përkatëse sipas modelit të miratuar, të cilat komisioni i mbrojtjes i merr në konsideratë si një ndër elementët e vlerësimit të studentit, pas 4 prezantimit të punimit të diplomës para tij.</p> <p>(Anex II_1_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Neni 84; Anex II_17_Kërkesat për përgatitjen e punimit të Diplomës)</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Punimi i diplomës mbrohet para Jurisë, të përbërë nga 5 anëtarë, të cilët propozohen nga Departamenti i Financës dhe miratohen nga Dekani. Në përfundim të çdo seance mbrojtjeje ditore, kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, u komunikon studentëve në grup vlerësimet për secilin.</p>

	<p>(Anex_I_3_Rregullore e KUQ, Neni 84, Neni 85;)</p> <p>Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e thjeshtë e të gjithë notave të antarëve të komisionit. (Anex_II_1_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Neni 85; Anex_II_6_Rregullore e Departamentit të Financës Neni 52;)</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën, duke fituar titullin Master Profesional në 'Finance'. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedura për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Diploma shoqërohet me suplementin e diplomës. (Anex_I_3_Rregullore e KUQ, Neni 86, Neni 87; Anex_II_1_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Nenet 86-90)</p> <p>Sipas RVB dhe anekseve përkatës, suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Çdo diplomë, përpara se të lëshohet nga KUQ, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe në regjistrin shtetëror të certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor që mbahet në QSHA. Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari nuk duhet të tërheqë atë dhe duhet të kërkojë paisjen me diplomë të rregullt. (Anex_I_3_Rregullore e KUQ, Neni 86, Neni 87; Anex_II_1_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Nenet 86-90; Anex_II_6_Rregullore e Departamentit të Financës, Nenet 53-56; Anex_III_1_1_Rregullore e Program Studimi FE_MP_Fin, Neni 19; Anex_II_1_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Neni 90 pika 4)</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në institucion, në përfundim të studimeve, institucioni ka si detyrë t'i vërë në dispozicion studenteve një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, sipas vitit akademik përkatës, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë.</p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p>	<p>Sipas RVB dhe në bazë të vizitës të ekspertëve në institucion, Zyra e Arkivës dhe Protokollit është e pajisur në përputhje me standardet specifike të funksionimit të saj dhe përmbush të gjitha kriteret për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit shkresor dhe online. Sipas nevojës, Zyra e Arkivës dhe Protokollit bashkërendon punën me Sekretarinë Mësimore dhe bën të mundur paraqitjen e informacionit të kërkuar nga ana e vetë institucionit apo studentit.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Plot përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Plot përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Nga vizita në KUQ, bazuar edhe në Anex_I_7_Rregullore e zyrës së Burimeve Njerëzore, me fillimin e vitit akademik, departamenti i Financës, pasi miraton planin mësimor përcakton pedagogët (Lektorët dhe As.Lektorët) që do japin lëndët/modulet e çdo programi studimi që mbulon ai të ndarë në semestra, duke ruajtur profilin e secilit.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit efektiv dhe me kontratë.</p> <p>Nga vizita e ekspertëve në institucion, u vu re se disa dosje të CV të personelit akademik ishin të pa plotësuara nga çfarë përmbante lista në Anex_II_8_Lista e dok në dosjen e personelit, si për shembull, dokumenta të panoterizuara etj.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në rregulloret Anex_I_3_Rregullore e KUQ; Anex_II_6_Rregullore e departamentit të Financës; Anex_I_7_Rregullore e Zyrës së Burimeve njerëzore dhe nga takimi me stafin drejtues që ekspertët e vlerësimit bënë gjate vizitës ekzistonin procedura te shkruara për rekrutimin e stafit akademik.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Gjithashtu edhe sipas RVB, Departamenti i Financës, bazuar në aktet e brendshme normative harton bën publike kriteret të përgjithshme dhe specifike, të cilat janë në përputhje me drejtimin dhe fushën e studimeve të departamentit, bazuar kjo në rregulloren e Departamentit të Financës Anex_II_6 Rregullore e departamentit të Financës.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Nga vizita në institucion ekspertët konstatuan që një pedagog i programit master profesional në financë kishte edukim të ndryshëm nga programi në fjalë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për</p>	<p>Në vizitën në institucion ekspertët konstatuan se anëtarët e stafit akademik të programit Master Profesional në Financë kanë zyra në dispozicion të pozicionuar në një nga katet e KUQ, i cili ka</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafaj», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

<p>kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>mundësi të punojë më mënyrë të pavarur në zyrën e tij. Në dispozicion të stafit akademik kishte kompjutera dhe pajisje të tjera ndihmëse si fotokopje, videoprojektor etj.</p> <p>Sipas edhe RVB si dhe Anex_I_11_7_Statistikë për mjediset e KUQ;), dhe sic u konstatua nga GVJ, sistemi i internetit wireless në mjediset e Fakultetit Ekonomik, krijonte kushte të mira për të përmirësuar edhe teknikat e mësimdhënies.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Ekspertët vunë re në institucion, si dhe në Anex_III_2_3_1_CV e stafit akademik ;Anex_I_7_1_Udhëzues për kualifikimin e personelit fundit; dhe RVB, që ekzistonin disa forma kualifikimi të personelit akademik si trajnime të tyre brenda vendit, pjesëmarrjen në konferenca shkencore, leksione të hapura dhe veprimtari të tjera.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nga vizita e ekspertëve, edhe pse në anekset Anex_I_7_1_Udhëzues për kualifikimin e stafit akademik; Anex_I_18_Sistemi Informatik dhe Metodatat e Mësimdhënies sistemet ekzistonin, u vu re se nuk aksesoheshin plotësisht nga studentët dhe stafi akademik.</p> <p>Gjithashtu u konstatua se zhvillimi i mësimit kryhej me videoprojektorë, dhe shërbimi i internetit ishte i aksesueshm.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Sipas anekseve më poshtë,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Anex_I_1_Statuti i KUQ; - Anex_I_3_Rregullore e KUQ, - Anex_II_1_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë - Anex_III_1_1_Rregullore e programit të studimit,MP Finance, <p>si dhe sipas RVB, konstatohet angazhimi dhe përpjekja e KUQ për sigurimin e burimeve optimale njerëzore, për përmbushjen e objektivave të programit MP Financë.</p> <p>Megjithatë, nga vizita në terren u konstatua që duhet të përmirësohet raporti i stafit akademik të brendshëm ndaj atyre të jashtëm, pavarësisht numrit të ulët të studentëve në këtë cilël studimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Asnjë</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit</p>	<p>Sipas, Anex_I_11_5_Raporti i vlerësimit (Relacioni i ambienteve të KUQ) . Anex_I_11_6_Planimetria e tri kateve të godinës së KUQ.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

Anex I II 7 Statistika e mjediseve të KUQ.

KUQ ka mjediset mësimore të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore brenda auditorëve. Kolegji dhe departamenti i tij plotësojnë normativën e sipërfaqes mësimore për student 2.5 m² të përcaktuara nga normativat shtetërore.

GVJ mbështetur në RVB si dhe gjatë vizitës në KUQ, konstatoi se:

- Treguesi, referuar numrit të punonjësve dispozicion të këtij programi studimi, rezulton 9.6 m²/për punonjës.
- Në mjediset didaktike të KUQ, dhe ato në të cilat zhvillohet ky program studimi, lartësia e mjediseve ku zhvillohen leksione dhe seminare është jo më e vogël se 3.0 m (tavan-dysheme). Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral.
- Të gjitha mjediset e godinave kanë sisteme portative të fikjes së zjarrit, paketën e ndihmës së shpejtë. Në godinë ka të instaluar dy motogenerator me paketa automatike, për furnizimin me energji elektrike, në rast ndërprerjeje të furnizimit nga rrjeti qëndror.

Godinat janë të pajisura me rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm përmes depozitave të ujit, të cilat bëjnë furnizimin në rast të ndërprerjes së furnizimit nga rrjeti qëndror i ujësjellësit.

Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjediset e tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.

Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.

Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.

Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të

Nga vizita në institucion dhe (**Anex I 18 Sistemi Informatik dhe Metodat e Mesimdhënies**), www.qiriaz.edu.al Platforma e-learning si dhe RVB, në funksion të mësimin për këtë program, ekzistojnë dy laborator informatike, ku në njërin prej tyre është të instaluar programi i kontabilitetit "FINANCË 5", ku aty zhvillohen lëndët e kontabilitetit të avancuar dhe Sistemet e Informacionit Kontabël.

Sipas Aneks I 11 5 Raport Vlerësimi (Relacion i ambienteve mësimore të Kolegjit; Anex I 13 Lista e bashkëpunimit ndërinstucional; dhe RVB dhe siç u

posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	konstatua, KUQ disponon kapacitetet e mjaftueshme për zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në planin strategjik të zhvillimit të kolegjit universitar, në lidhje me shërbimin e bibliotekës, u konstatua se, pavarësisht ambienteve komode, të rregullta dhe të përshtatshme, biblioteka duhet të pasurohet më tepër me periodikë dhe revista të ndryshme, libra të lidhur veçanërisht me fushën e financës, etj. Gjithashtu literaturave bazë e programit Master Profesional në Financë ishte e kufizuar.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka online nuk ishte e aksesueshme nga pedagogët dhe nga studentët e programit të MP në Financë.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Ashtu siç edhe Ju pohua GVJ gjatë vizitës në Institucion por edhe siç është paraqitur edhe në RVB, studentët e programit MP në financë u ofrohet akses në bibliotekë pa pagesë.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Sic edhe u pa në institucion, biblioteka ishte e konceptuar si një sallë studimi që krijonte mundësinë për të punuar në mënyrë individuale apo edhe në grup. Sic përmendet edhe në RVB si ambient i lirë për t'u përdorur nga të gjithë studentët e KUQ për qëllime studimore, është edhe salla e internetit, e cila është e pajisur me pajisje kompjuterike (Kompjuter, videoprojektorë), ku si biblioteka ashtu edhe salla e kompjuterave përdoren në orare të caktuara
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Edhe pse institucioni bën përditësim të bibliotekës me literatura të reja, siç përmendet në vlerësimin e kriterit 1 të këtij standardi, literatura për fushën e financës duhet të pasurohet si me tekste mësimore ashtu edhe me periodikë të fushës përkatëse. Ky lloj pasurimi duhet të bazohet në një plan të detajuar që mbështet programin e studimit.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të	Nga vizita u konstatua që biblioteka qëndronte e hapur vetëm gjatë orareve të procesit mësimor.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sipas Anex_I_1 Statuti i KUQ të dhënat personale në lidhje me studentët dhe aktivitetin e tyre regjistrohet dhe arkivohet nëpërmjet një sistemi menaxhimit të brendshëm, bazuar e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Nga vizita u konstatua që: ekziston regjistri themeltar i studentit i cili vërteton regjistrimin e studentit që pajiset me numër matkulimi përveç një rasti të evidentuar nga ekspertët i cili nuk kishte numër matkulimi me arsyetimin se përgjegjja ndaj kërkesës së bërë në QSHA nuk kishte ardhur.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Nga vizita e ekspertëve, (Anex_I_1 Statuti i KUQ) dhe RVB u konstatua që, administrohet informacioni në lidhje me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ. Informacioni që ruhet për stafin akademik, ndihmës akademik, dhe të angazhuar dokumentohet përmes CV, planeve mësimore, syllabuseve, ngarkesës akademike. Këto dokumente ruhen në departament dhe bëhen pjesë integrale e analizës mësimore dhe shkencore të departamentit.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Nga konstatimi në web-in e KUQ, ekspertët vënë re se ekzistojnë informacione të përgjithshme për sa i përket dokumentacionit, personelit akademik si dhe për studentët e programit të studimit në Master Profesional 'Financë'.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Nga vizita e ekspertëve edhe pse ne anekset Anex_I_7_1 Udhëzues për kualifikimin e stafit akademik; Anex_I_18 Sistemi Informatik dhe Metodatat e Mësimdhënies sistemet ekzistojnë, u vu re se ato nuk aksesoheshin plotësisht nga studentet dhe stafi akademik. Komunikimi ndërmjet personelit dhe studentëve bëhej kryesisht nëpërmjet emaileve personale.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Nga vizita e ekspertëve, si dhe parë në anekset 1.(Anex_II_1 Rregullore e Fakultetit Ekonomik; 2.Anex_I_5_1 Rregullore e NJSBC; 3.Anex_I_7 Rregullore e zyrës së Burimeve njerëzore), si dhe raporti i RVB, u konstatua që monitorimi i aktivitetit akademik e administrativ mundësohet nga sistemi i menaxhimit i cili kryen

	raportime individuale, për organet drejtuese dhe titullarët. Monitorimi përfshin: respektimin e orarit mësimor, ngarkesës mësimore, etikës në komunikim, dokumentacionit duke hartuar çdo vit një përmbledhje të ngarkesës mësimore, akademike. Raportet e monitorimit dhe vlerësimit përcillen në fakultet.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Nga Vëzhgimi i ekspertëve në faqen e internetit të KUQ jepen në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme. Por u vu re se në gjuhën angleze kishte ende shumë informacione të paplotësuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga vëzhgimi i ekspertëve në institucion, bazuar dhe në Anex_I_3_Rregullore e KUQ_neni 103. Anex_I_15_Raporti vjetor si dhe RVB cilësohet se : Bordi i Administrimit përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si edhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit. Bordi i Administrimit siguron qëndrueshmërinë financiare në Institucion, ku si pjesë të planit të tij financiar ka buxhetimin e të ardhurave dhe alokimin e tyre. Gjithashtu, shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në Kolegji Universitar “Qiriazi” bëhet në bazë të një Plani Financiar. Struktura e Planit financiar është bërë duke i klasifikuar të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet sipas drejtimeve në të cilin ato do të përdoren. Pra edhe sipas anekseve si më poshtë: Anex_I_16 Plani financiar për menaxhimin me efektivitet e institucionit (Anex_I_20 Pasqyrat e financiare vjetore) u vu re se: Burimet financiare të institucionit janë të ardhurat e realizuara nga vetë Institucioni. Ai nuk ka përfituar grande apo donacione të tjera nga të tretët. Të ardhurat e realizuara gjatë gjithë vitit ushtrimor, bazohen në kontratat që lidh institucioni me çdo student, gjithashtu ky deklaram të ardhurash bëhet sipas procedurave tatimore, me anë të faturës tatimore.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtje e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të hu të përfituara dhe kontratat e shërbimit të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

55

<p>financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Grupi i ekspertëve konstatoi se KUQ ka hartuar pasqyra financiare me detaje përkatëse, Anex_I_20 Pasqyrat e financiare vjetore, por këto pasqyra nuk janë të audituara nga auditues të jashtëm.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Notë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Notë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1				
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Sipas Rregullores së Fakulteti të Ekonomisë dhe Rregullores së programit të studimit, KUQ përcakton qartësisht politika dhe procedura transparente për barazinë dhe të drejta për të gjithë kandidatët për studentë në këtë program studimi. Këto politikat dhe procedura shoqërojnë studentët nga hyrja e tyre në fakultet e deri në diplomim, duke garantuar të drejta të barabarta për të gjithë studentët që ndjekin këtë program studimi. Këto politika sigurojnë, informim për kriteret, afatet dhe procedurat e kalimit nga njëri vit në tjetrin dhe nuk përmbajnë asnjë kriter tjetër skualifikimi.			
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.				
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Nga RVB, Anex 1_18 Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies, si dhe nga vizita në institucion, u konstatua se çdo individ i interesuar për mënyrën e aplikimit, kriteret e pranimit, transferimet e studentëve, ka informacion të aksesueshëm në faqen e webit, www.qiriazi.edu.al .			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Referuar Aneks II 1 Rregullore FE; Aneks I 9 Rregullore e Sekretarisë mësimore; Aneks III 1_1 Rregullore e Programit të studimit MP Financë Anex 1_14 Kriteret e pranimit të studentëve në KUQ informacioneve specifike të paraqitur nga KUQ, informon rregullisht studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e tij të studimit.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Nxitja e studentëve kandidat për të studiuar në këtë program studimi bëhet përmes publikimit në faqen e web-it i gjithë informacionin e nevojshëm, i cili është i aksesueshëm nga të gjithë. Bazuar edhe në rregullore si edhe nga verifikimi në faqen e internetit, informacioni i nevojshëm është i aksesueshëm nga të interesuarit edhe në web: www.qiriazi.edu.al . Përsa i përket zyrës së karrierës, ajo nga vizita e ekspertëve u shpreh se për studentët të këtij programi studimi nuk kishin akoma një program aktivitetesh			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Mbështetur në: Anex_I_3_Rregullore e KUQ; Anex_II_6_Rregullore FE; Anex_III_1_1 Rregullore e Programit të studimit Master i Shkencave, Financë si dhe Raporti i RVB Departamenti i Financës, arrin të shpërndajë informacionin për kalimin nga një vit në tjetrin, nëpërmjet zyrës së Karrierës dhe nëpërmjet sekretarisë. Nga vizita e ekspertëve u vu re se këtë proces e kryente vetëm zyra e sekretarisë dhe jo zyra e karrierës.								
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Gjithashtu sipas rregulloreve përkatëse KUQ ofron ekuivalentim të pjesshëm ose të plotë të programit të studimit ose diplomave të marra nga institucione të tjera brenda ose jashtë vendit.								
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësi të studentëve në programin e studimit.	Procesi i ekuivalentimit fillon me paraqitjen e kërkesës nga ana e studentit dhe vazhdon me ngritjen e Komisionit të Njohjes dhe Ekuivalentimit të Studimeve.								
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Pra, studimet e ciklit të dytë Master Profesional në Financë përmyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i Profesional" në Financë kjo sipas RVB si dhe vizitës në institucion. FE, nëpërmjet zyrave përkatëse, sistemit të menaxhimit të informacionit dhe sekretarisë së KUQ informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimin në programin e studimit.								
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Sipas RVB dhe vizitës në institucion, KUQ realizon në mënyrë periodike, në fund të vitit akademik, në fillim të vitit të ri akademik takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit, gjithashtu edhe çdo pedagog jep kontributin e tij në informimin e studentëve.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Sik përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Sik përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Sik përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën,	

<p>organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Nga takimi me drejtues të institucionit, si edhe nga takimi me studentët, ekspertët konstatuan që:</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Departamenti i Financës informon studentët në mënyrë të hollësishme në lidhje me strukturën, organizimin e kohëzgjatjen e programit të studimit Master Profesional në “Financë”.</p> <p>Mbështetur dhe në (Anex III 2 1 Dosja e programit studimit MP_Finance, Kreu III; Anex II 6 Rregullore e Departamentit të Financës, Kreu I V;) dhe nga RVB, ky informim realizohet në disa forma. Një nga mënyrat e informimit është përmes website-it të KUQ (www.qiriaz.edu.al;) Në fillim të çdo viti akademik, bëhet i mundur informacioni në lidhje me strukturën e vitit akademik në të cilën detajohet kohëzgjatja e vitit akademik, ndarja e tij në semestra, periudha e provimeve etj. Kohëzgjatja normale e Programit të studimit të Ciklit të dytë MP në Financë është 1 vit akademike (60 kredite) dhe viti akademik ndahet në dy semestra. (Anex III 1 1 Rregullore e Program Studimi FE_MP_Financë (Anex III 2 1 Dosja e programit studimit).)</p> <p>KUQ pasqyron në faqen e internetit planin mësimor për çdo program studimi. Në hollin e Kolegjit afishohet plani mësimor me emrat e pedagoqeve për çdo lëndë/modul.</p> <p>Nga takimi i GVJ me studentët u tha që: Me të gjithë studentët e rinj bëhet takim ditën e parë të mësimit ku njihen me institucionin, me programet e veprimtaritë që ofrohen në këtë kolegji.</p> <p>Nga diskutimi edhe me pedagogët e këtij programi u tha që: në orën e parë të mësimit i informon studentët për përmbajtjen e lëndës/modulit, elementët përbërës të saj, detyrimet dhe vlerësimi i studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Edhe pse në rregulloret përkatëse në KUQ mënyra e informimit është e qartësuar mbi mundësitë e punësimit, ajo çfarë u konstatua nga vizita e ekspertëve në zyrën e karrierës, ishte se kjo zyrë funksiononte vetëm për studentët e ciklit BA</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Mbështetur në rregulloren e FE dhe programit të studimit MP në Financë, nga RVB, dhe nga vizita në institucion u konstatua se studentit i ofrohet një informacion i hollësishëm në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, nëpërmjet planit mësimor, orarit të mësimit, ku janë të përcaktuara saktë sallat, ora dhe pedagogu përkatës.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Ky informacion është i paraqitur online dhe i afishuar në ambientet e shkollës.</p> <p>Informacioni në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor bëhet i aksesueshëm nëpërmjet email të çdo pedagogu dhe studenti të cilët komunikojnë me pedagogun e modulit për leksionet, detyrat e shtëpisë, detyrat kursit dhe probleme të tjera të mësimit literaturën e detyruar dhe ndihmëse për lëndën/modulin.</p>

	Gjithashtu, edhe sipas RVB dhe çfarë ekspertët konstatuan ishte se dokumentacionet kryesore për pasqyrimin e aktivitetit të procesit mësimor janë: <ul style="list-style-type: none"> • syllabuset e moduleve, • plani mësimor, • dosja e programit të studimit, • rregjistri i pedagogut, • raportet vjetore të departamenteve. 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Sipas vizitës së ekspertëve si dhe RVB, u konstatua se KUQ mban statistika vjetore për numrin e të diplomuarve për të gjitha programet. KUQ disponon statistika duke filluar nga departamenti, fakulteti dhe rektorati për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë largimet nga programi, si dhe largimet nga kolegji, apo mospërfundimin e të vitit akademik.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Këto të dhëna pasqyrohen në analizat vjetore dhe në raportin vjetor të Rektoratit: Anex_I_15_Raportet vjetore të Rektoratit; Anex_II_15_Numri i studentëve në vite sipas programve; Anex_I_9_Rregullore e sekretarisë mësimore Referuar të dhënave në RVB, numri i studentëve në vite është si më poshtë: Viti akademik 2017-2018 - 1 student i regjistruar për herë të parë në vitin e parë; nota mesatare në hyrje 8.02.. Viti akademik 2019-2019 - 2 studentë të regjistruar për herë të parë në vitin e parë; nota mesatare në hyrje 8.01. Të dy studentët janë të matrikulluar. Siç edhe e kemi paraqitur edhe më sipër, GVJ bëri vizitë edhe në sekretarinë mësimore, ku pa regjistrin themeltar/amzës dhe regjistrin e arritjeve akademike (regjistrin e notave). Punonjësja e sekretarisë ishte e re në këtë detyrë dhe nuk mund të jepte shpjegime për ecurinë në vite dhe shënimet e bëra në regjistrin e studentëve. Sipas regjistrin themeltar, numri i studentëve të regjistruar ndër vite, rezulton si më poshtë: Viti akademik 2017-2018 – 1 studentë të regjistruar për herë të parë në vitin e parë, Studenti është i matrikulluar. Nuk është i

	<p>diplomuar, pasi sipas Sekretares, studenti pret të përfundojë procesi i akreditimit të programit Viti akademik 2018-2019 – 2 studentë të regjistruar për herë të parë në vitin e parë, të 2 studentë të matrikulluar U panë dy procesverbalë të dy provimeve dhe rezultoi se hedhja e notave në regjistër ishte korrekte.</p>			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	<p>Nga verifikimi ekspertëve në regjistrave përkatës, nga Anex_I_9 Rregullore e sekretarisë Mësimore; Anex_II_1-14 Numri i studentëve të regjistruar ndër vite, si dhe RVB, u konstatua se:</p>			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Sekretaria informon studentët me këtë informacion dhe strukturat drejtuese të kolegjit. Këtë vit akademik departamentet kishin të dhëna të plota për rezultatet e provimeve për çdo student, si të dhëna statistikore përmbledhëse për programin e studimit. Të dhënat janë të ruajtur në regjistra me të dhëna standarde të miratuara nga MASR.</p>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	<p>Sipas Anex_I_15 Raportet vjetore të KUQ, vizitës së ekspertëve dhe RVB, në raportet vjetore të organeve drejtuese janë cilësuar rezultatet e studentëve sipas programeve të studimit. Vitin e kaluar akademik (2017-2018) ishin vetëm disa diplomime për të cilët disponohen të dhëna të plota si për notat mesatare në hyrje dhe dalje.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Asnjë përbushje	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Sipas takimit të ekspertëve me studentë, bazuar edhe në (Anex_I_1 Statuti i KUQ, nenet 8,9,43) (Anex_II_1 Rregullore FE;) (Anex_III_1_1 Rregullore e Program Studimi FE_MP_Fin) si dhe RVB, u vu re se : Ka të përfshirë studentë dhe përfaqësues të saj në organet vendimmarrëse e këshilluese me një numër të përcaktuar nga këto akte rregullatore. Studentët e KUQ përfaqësohen në organe drejtuese të Kolegjit si Senati, NJSBS dhe në Komisioni i Etikës që janë struktura funksionale që zgjidhen në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Studentët përfaqësues në organet vendim-marrëse shprehin opinionin e tyre për planet mësimore, programet mësimore, çështje të etikës etj.</p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	

	<p>Gjithashtu, Senati Akademik i KUQ-së, NJSBC bazuar në Statutin e KUQ ka në përbërjen e tij edhe studentët.</p> <p>Në KUQ, ka të përfshirë studentë në dy Komisione të përhershme, në Komisionin e Etikës dhe Komisionin për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit.</p> <p>Studentët përfaqësues në këto organe vendimmarrëse shprehin opinionin e tyre për çështje të cilësisë në programin e studimit, çështje të etikës së studentëve dhe stafit akademik etj.</p> <p>Pavarësisht, përcaktimeve në aktet rregullatore për rolin e studentëve si më sipër, në këtë program mësimor përfshirja e studentëve në këto organe vendimmarrëse nuk ishte e plotë, për shkak të numrit të kufizuar prej dy studentësh. në program</p>			
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme.</p>	<p>Mbështetur në Anex_III_11_Rregullore e Programit të studimit Master i Profesional në Financë , RVB si dhe nga vizita e ekspertëve, GVJ konstaton se në hartimin dhe propozimet për përmirësimin e programit të studimit Master Profesional në “Financë”, Departamenti i Financës ka mbajtur parasysh ngarkesën akademike të përcaktuar të studentëve, e cila është e përcaktuar në Kurrikulën e programit të studimit dhe Planin mësimor të miratuar.</p> <p>Nga takimi me studentët ata thanë se ky program studimi ka ngarkesë akademike normale.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Gjithashtu, mbështetur në Statutin e KUQ, Rregulloren e FE dhe Rregulloren e Departamentit të Financës, neni 65, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, atyre u rezervohen një seri të drejtash që i krijojnë atij mundësinë jo vetëm të përfaqësojë interesat e tij por edhe të shprehë lirisht përmes rregullave dhe procedurave opinionin e tij.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nga konstatimi i ekspertëve, si dhe nga RVB dhe rregullorja e departamentit të financës, dokumentacioni bazë i vlerësimit të studentëve është regjistri i pedagogëve, i cili ka informacion për frekuentimin, aktivizimin, vlerësimin përfundimtar dhe firmoset nga pedagogu i lëndës dhe nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Dokumenti tjetër i rëndësishëm është procesverbali i rezultateve përfundimtare, ku aty janë të shënuara pikët e mara gjatë vitit, pikët e provimit përfundimtar dhe nota përfundimtare.</p> <p>Ky procesverbal firmoset nga pedagogu i lëndës, nga përgjegjësi i departamentit dhe nga anëtarët e komisionit të provimit .</p> <p>Studentët u shprehën para ekspertëve se:</p> <p>u është mundësuar, nëpërmjet anketimit të tyre me anë të pyetësorëve, të japin mendimet e tyre, në mënyrë të pavarur e të pa ndikuar mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>Sipas akteve rregullatore si më poshtë: (Anex_I_9 Rregullore e sekretarisë mësimore) Anex_I_18 Sistemi informativ dhe metodat e mësimdhënies, institucioni ka rregulluar mënyrën e dhënies së informacionit për studentët. Gjithashtu, instiucioni ka ndërtuar portalin e-learning, si dhe përdor adresën e web: www.qiriazi.al, ku studentët mund të marrin informacion në lidhje me procesin mësimor.</p> <p>Sipas statutit të KUQ, si dhe RVB (Anex_I_1 Statuti i KUQ, nenet 8,9,43; Anex_I_8 Rregullore e zyrës mardh jasht pranimit kshillit per karriere;), institucioni ka përcaktuar në këto akte mënyrën e funksionimit të Zyrës së Karrierës dhe Këshillimit, me rol në këshillimin e studentëve, orientimin e tyre dhe duke i informuar ata rreth zhvillimit të programit të studimit, duke i këshilluar në zgjedhjet e tyre për drejtimet e mara në tregun e punës. Nga vizita në terren ekspertët konstatuan se Zyra e Karrierës nuk ndiqte ecurinë e studentëve të këtij programi.</p>								
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .									
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.									
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse									
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Plotësisht përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X		
Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
	X								

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në aktet e brendshme rregullatore si : (Anex I_1 Statuti i KUQ, neni 43;) (Anex I_5_1 Rregullore e NJSBC-se;) (Anex II_1 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë), RVB si dhe nga takimi i ekspertëve me drejtuesit të NJBSC të KUQ, kjo njësi ndjek realizimin e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Gjithashtu, kjo njësi vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative e financiare të KUQ. Ai ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit.</p> <p>Zbatimi i rregullores për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë ndiqet kryesisht nga strukturat e sistemit të brendshëm të cilësisë dhe nga Njësia e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë. Përmes zbatimit të pyetësorëve dhe përmes mbledhjeve të hapura në të cilat marrin pjesë edhe studentët, ata nëpërmjet opinionëve të tyre i jepnin rëndësi sigurimit të cilësisë në KUQ si dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm të saj.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sipas RVB, dhe siç konstatuan edhe ekspertët në vizitë, institucioni e realizon Sigurimin e Jashtëm i Cilësisë nëpërmjet proceseve për vlerësimin e jashtëm të akreditimit, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësisve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Sipas, Anex I_5_1 Rregullore e NJSBC-së, dhe nga vizita e ekspertëve, KUQ analizon kryesisht mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës, opinionin e studentëve dhe të pedagogëve. Gjithashtu sigurimi i vazhdueshëm i cilësisë zbatohet përmes veprimtarisë së strukturave drejtuese, aktivitetit të NJSBC.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Sipas vizitës së ekspertëve, RVB si dhe Anex II 6 Rregullore e Departamenti MF ; u vu re se monitorimi, shqyrtimi, mbikëqyrja dhe rishikimi i programeve të studimit në FE, kryhen nga departamenti. Procedura e rishikimit të programit studimor fillon nga departamenti me propozime për rishikimin e programit studimor (jo më shumë se 20% të programit), i cili jep mendim mbi ndryshimet e kërkuara dhe ia përcjell dekanatit dhe ky i fundit ia përcjell Senatit për miratim. Nga vizita në KUQ bazuar edhe në dokumentacion, këto dy vitet e fundit nuk ka patur ndryshime në këtë program.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Bazuar në aktet e brendshme rregullatore si : (Anex I 1 Statuti i KUQ, neni 43;) (Anex I 5 1 Rregullore e NJSBC-se;) (Anex II 1 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë), RVB si dhe nga takimi i ekspertëve me drejtuesit të NJBSC të KUQ, kjo njësi ndjek realizimin e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. Gjithashtu, kjo njësi vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative e financiare të KUQ dhe ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Zbatimi i rregullores për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë ndiqet nga strukturat e sistemit të brendshëm të cilësisë dhe nga Njësia e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë. Përmes zbatimit të pyetësorëve dhe përmes mbledhjeve të hapura në të cilat marrin pjesë edhe studentët, ku ata nëpërmjet opinionëve të tyre i jepnin rëndësi sigurimit të cilësisë në KUQ si dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm të saj.
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Sipas RVB, Anex I 5 1 Rregullore e NJSBC; Anex II I Rregullore e Fakultetit Ekonomik; Anex II 6 Rregullore e Departamenti Financës; Anex I 5 Manuali i Cilësisë; dhe vizitës së ekspertëve në KUQ, u vu re se KUQ përdor disa metoda për matjen dhe vlerësimin e programit Master Profesional në Financë, ndër to ishte edhe nga mbledhjet e departamentit ku merret mendimi i stafit si dhe nga fokus grupet e studentëve. Nga takimi me përgjegjësën e departamentit ekspertët konstatuan që mbledhjet e departamentit kryheshin vetëm në fillim të vitit akademik, pra gjatë vitit akademik mungonin vlerësimet e studentëve apo të stafit për ecurinë e këtij programi.
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve	Nga vizita e ekspertëve në institucion nuk iu paraqit ndonjë raport apo dokument i shkruar i rasteve të vlerësimeve apo edhe

përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	masave nëse do kishte nevojë për përmirësim të programit MP në Financë.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Sipas vizitës së ekspertëve, RVB si dhe Anex II 6 Rregullore e Departamenti MF ; u vu re se monitorimi, shqyrtimi, mbikëqyrja dhe rishikimi i programeve të studimit në FE, kryhen nga departamenti. Procedura e rishikimit të programit studimor fillon nga departamenti me propozime për rishikimin e programit studimor (jo më shumë se 20% të programit), i cili jep mendim mbi ndryshimet e kërkuara dhe ia përcjell dekanatit dhe ky i fundit ia përcjell Senatit për miratim. Nga vizita ne KUQ bazuar edhe ne dokumentacion, këto dy vitet e fundit nuk ka patur ndryshime në këtë program. Gjithashtu NJBSC ndjek realizimin e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. Kjo njësi vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative e financiare të KUQ dhe ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Zbatimi i rregullores për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë ndiqet nga strukturat e sistemit të brendshëm të cilësisë dhe nga Njësia e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si	Sipas akteve rregullatore të brendshme (Anex I 5_1 Rregullore e NJSBC; Anex I 5 Manuali i cilësisë; Anex II 12 Pyetsori i studentëve), KUQ përdor metoda vlerësimi si intervista dhe pyetësorë studenteve aktualë. Nga konstatimi i eksperteve në institucion, anketimi i studentëve nëpërmjet pyetësorëve është një instrument i rëndësishëm që përdoret për vlerësimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit, rezultatet e të cilit bëhen të njohura dhe shërbejnë si një bazë orientuese për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.

provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.				
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Sipas Anex_I Statuti i KUQ, neni_43 ; Anex_I_5_1 Rregullore e NJSBC, Anex_I_1_1 Organigrama e KUQ, RVB dhe sic ekspertët konstatuan, ishte se KUQ ka parashikuar politika që kanë të bëjnë me zbatimin e procedurave për sigurimin e cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Gjithashtu sipas strukturës organizative dhe hierarkisë të KUQ përgjegjësitë për cilësinë janë në të gjitha nivelet drejtuese (departament, fakultet, reaktorat) të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të saj. Veprimtaria e NJSBC është e rregulluar sipas rregullores Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila është bazuar në legjislacionin në fuqi dhe Statutin e Kolegjit Universitar „Qiriazi” Sigurimi i brendshëm i cilësisë së programit të studimit në KUQ, është konceptuar si përgjegjësi e menaxhimit: <ul style="list-style-type: none"> • angazhimi i gjithë strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë; • sigurimi i burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për të garantuar dhe përmirësuar cilësinë; • hartimi i programeve cilësore që plotësojnë nevojat e shoqërisë;

	përcaktimi i parimeve, standarteve dhe proceduarave të përshtatshme për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë.			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Për realizimin e planit mësimor për çdo program studimi, FE koordinon veprimtarinë mësimore-shkencore në të tre departamentet. Kjo mundëson mirëorganizimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Përcaktimi i ngarkesës mësimore në KUQ bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Gjithashtu, rregullorja e KUQ, Rregullorja e FE, Rregullorja e NJSBC, garantojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazitë kundrejt personelit dhe studentëve.			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.				
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Sipas RVB, pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë ishin ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit. Megjithatë, nga vizita e ekspertëve nuk u arrit të verifikohet kjo gjë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Sipas akteve rregullative të përmendura në RVB si dhe nga vizita e ekspertëve në institucion, u vu re se, mbledhja e informacionit për sistemin e sigurisë janë pyetësorët e realizuar studentëve për çdo semestër. Anketat e pyetësorëve përpunohen dhe i vihen në dispozicion të drejtuesve të institucionit.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	NJSBC aktivitetin e saj e zhvillon sipas një plani kalendar të përvitshëm, në të cilin programohen kontrollat në sektorët apo proceset që i nënshtrohen kontrollit/vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Sipas RVB, Anex_I_5_2_Politikat e Vlerësimit të Brendshëm, dhe takimit të ekspertëve në institucion, NJSBC raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve gjithashtu rekomandon detyra, zbatimin e të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë NJSBC, në disa raste janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm.

<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas Anex I_15 Raportet vjetore të KUQ, RVB dhe vizitës së ekspertëve ne KUQ, u konstatua se: njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të Kolegjit dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm vjetore. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e KUQ, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Nga takimi i ekspertëve me drejtues të institucionit, NJSBC si dhe përgjegjësin departamentit të financës, u kontestua se organizohen takime me stafin dhe studentët në sigurimin e cilësisë së programit kryesisht në fillimi të vitit akademik. Megjithatë, në kuadër të përmirësimit afatmesëm dhe afatgjatë të cilësisë së programit të Masterit Profesional në ‘Financë’, ekspertët nuk evidentuan takime të formalizuara me stafin e brendshëm, të jashtëm dhe studentët si dhe të aktivitete trajnuese për aktet rregullatore të institucionit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Profesional në “Financë” të Institucionit të Arsimit të Lartë të Kolegjit Universitar “Qiriazi”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programet e studimit të Kolegjit Universitar ‘Qiriazi’ (KUQ) nuk bien ndesh me interesat kombëtare, kjo për shkak të natyrës specifike shkencore të degëve të ndryshme të ofruara.
2. Një pjesë e personelit akademik zotëron tituj akademikë dhe eksperiencë të gjatë në tregun e punës (si ish anëtar të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, si anëtar të SHKFSH etj.). Serioziteti dhe angazhimi i drejtuesve të institucionit jep garanci në realizimit e programit Master Profesional në “Financë”.
3. Përgjithësisht, ambientet e KUQ, të dedikuara për procesin mësimor, janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave. Në sallat e dedikuara për leksion/seminar gjenden të gjithë elementët e nevojshëm për një zhvillim normal të procesit mësimor.
4. KUQ është një institucion relativisht i vogël, por kjo mund të konsiderohet edhe si një avantazh për studentët. Institucioni ka mundësinë t’u ofrojë atyre mbështetje dhe kujdes të vazhdueshëm, duke i këshilluar për karrierën e tyre akademike, mundësitë e

ndryshme për praktikë dhe punësim pas diplomimit ose probleme të tjera të ndryshme të karakterit personal.

5. KUQ ka vënë në zbatim metoda inovative të mësimdhënies, ruajtjes së informacionit, informimit dhe komunikimit. Platforma e të mësuarit në distancë 'e-learning', e cila aplikohet në KUQ, realizohet duke përdorur aplikacionet elektronike nëpërmjet internetit, rrjetit, apo kompjuterit personal duke shkëmbyer aftësitë dhe njohuritë në mënyrë virtuale. LMS (Learning management system) mundëson menaxhimin dhe administrimin e procesit mësimor. 'Moodle', i njohur edhe si Mjedisi Virtual i të Mësuarit (Virtual Learning Environment) është një platformë edukimi ndërkombëtare e cila është përpunuar duke iu përshtatur strukturës së KUQ.

Pika të dobëta

1. Dokumentacioni i paraqitur në kuadrin e akreditimit të këtij programi në disa raste ka mangësi dhe nuk është i organizuar. Mbajtja dhe përditësimi i të dhënave të personelit nuk është në nivelin e duhur.
2. Paqëndrueshmëria e stafit, si dhe procedurat formale të rekrutimit (veçanërisht, për stafin me kohë të plotë) çënojnë cilësinë e mësimdhënies dhe nuk garantojnë qëndrueshmëri. Gjithashtu, kërkimi shkencor si dhe mbështetja financiare e drejtpërdrejtë e personelit akademik për kërkimin shkencor duhet të rritet.
3. Siç theksohet në anekset përkatës, përpara hapjes së programeve të studimit të profileve të ndryshme, KUQ kreu një analizë të tregut të punës. Përgjithësisht, në këto studime, autorët duhet të japin sqarime të detajuara mbi metodologjinë statistikore të përdorur, si dhe mbi statistikën përshkruese të lidhura me kampionët e përdorur. Studimi i publikuar është relativisht i limituar, si në volum, ashtu edhe si produkt shkencor.
4. Në institucion ka zyra, të cilat janë të angazhuara edhe me këtë program studimi, të cilat funksionojnë vetëm formalisht, duke mos përmbushur detyrat përkatëse (për shembull, zyra e këshillimit të karrierës). Grupet e vlerësimit të cilësisë dhe sistemi i kontrollit të cilësisë nuk janë gjithnjë funksionalë. Në këtë grup, asnjë nga anëtarët nuk ishte pjesë e stafit akademik të njësisë bazë të këtij programi.

Rekomandime

1. Analizat e ardhshme të tregut të punës nga institucioni duhet që jenë më të plota, të bazuara në shifra dhe parashikime konkrete. Këto analiza duhet të kenë formën e një punimi shkencor të mirëfilltë, si nga ana formale, ashtu edhe nga përmbajtja.
2. Brenda një afati kohor të shkurtër programi mësimor duhet të ndryshojë për t'u plotësuar dhe përputhur me standardet dhe aktet rregullatore. Gjithashtu, duhen realizuar masa të shpejta që dokumentimi i veprimtarisë së programit të bëhet në mënyrë sistematike dhe cilësore. Programi i MPF mund të rishihet në mënyrë të pjesshme. Në opinionin tonë, disa lëndë mund të zhvillohen në një mënyrë më praktike, me qëllim ngushtimin e fokusit të studimeve. Konkretisht, mund të shtohen programe të rinj kompjuterikë në programet e disa lëndëve, me qëllim përgatitjen më efikase të studentëve për tregun e punës.
3. Rekomandojmë që brenda një kohe të shkurtër të përditësohen dhe organizohen të dhënat e personelit. Gjithashtu, departamenti dhe fakulteti duhet të rritin transparencën në rekrutimin e stafit të akademik.
4. Rekomandojmë që në planin financiar të institucionit të parashikohet një shumë mbështetëse për aktivitetet e kërkimit shkencor të personelit akademik të programit.



5. Strukturat mbështetëse duhet të vihen në funksion të këtij programi, të formalizohen dhe të funksionojnë sipas standarteve të kërkuara.

Conclusions from the Evaluation of the Second Cycle Study Degree 'Professional Master Program in Finance' of the Higher Education Institution 'Qiriazi University College'

Strengths and affirmations

1. The study programs of 'Qiriazi University College (QUC)' are not in conflict with Albanian national interests, due to the specific scientific nature of the various offered courses.
2. A significant part of the academic staff possess academic titles, long experiences in the labour market and relevant professional memberships (e.g. former members of the National Accounting Council, members of the Association of Accountants and Financiers of Albania etc.). The continuous commitment of the heads of the institution also guarantees the realisation of the 'Professional Master Program in Finance (PMPF)'.
3. The QUC facilities are generally functional and equipped with all the respective logistics, necessary for a qualitative learning environment. The lectures rooms contain all the necessary elements for a normal teaching process.
4. QUC is a relatively small institution but this can also be considered as an advantage for the students. The institution has the opportunity to support them continuously, and to advise them on their academic careers, possible internship and employment opportunities after graduation and other personal problems.
5. QUC has implemented innovative methods of teaching, information storage and communication. QUC professors and students use the 'e-learning' platform in order to share skills and knowledge via internet. LMS (Learning Management System) is an 'e-learning' software application, useful for the administration of university courses. QUC staff and students also use VLE (Virtual Learning Environment), a modern web-based platform for the digital aspects of courses of study.

Weak points

1. The necessary documents needed for the accreditation of this master program are in some cases incomplete and unorganised. The respective administrative employers should update and organise staff files and data.
2. Staff instability, as well as formal recruitment procedures (especially for full-time staff) negatively affect teaching quality. QUC should also increase direct financial support for scientific research.
3. According to the respective annex, QUC conducted a labour market study prior to the opening of the master program. Generally, in these studies, the authors should provide detailed explanations of the statistical methodology, as well as descriptive statistics related to the corresponding samples and populations. This labour market study does not fulfil the requirements of a good scientific work.

4. There are offices in the institution, which are also involved with this study program, which operate only formally, but do not fulfill their respective duties (for example, the career counselling office). Quality assessment groups and the quality control system are not always functional. In the quality assessment group, none of the members were part of the academic staff of this program.

Recommendations

1. Future labor market analysis by the institution should be more complete, based on the numbers and concrete forecasts. These analyses should take the form of a genuine scientific work, both formally and in content.
2. Within a short period of time, the curriculum must be changed in order to meet and comply the standards and the regulatory acts. Rapid measures should also be taken so the documentation process of the program activity is done systematically and qualitatively. The Master of Arts in Finance program may be partially revised. On our opinion, some courses may be developed in a more practical way, with the aim of narrowing the focus of studies. Specifically, new computer programs may be added to the curricula of some subjects in order to prepare students more effectively for the labor market.
3. We recommend personnel data to be updated and organized continuously within a short time. The Faculty and the Department should increase the transparency in the recruitment process of the academic staff.
4. We recommend that in the financial plan of the institution there should be foreseen an amount of money in order to support the research activities of the academic staff of the program.
5. Supporting structures should be put into operation of this program, formalized and functioning to the required standards.

Evaluation Experts:

1. **PhD. Dritan Fino**
2. **PhD. Visar Malaj**



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushja	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT		X		
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE		X		
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

